Faqe 10-11
Del lista e konkurrenteve femra për shkollen e policisë

Faqe 2-3
Deputetët që munguan në Kuvend, qeveria s'bën numrat

Faqe 5
PD: OK propozimit të të vegjëlve por rrisim pragun elektoral 5 %

Faqe 6
Panairi Klik Ekspo Klik Topi takon bizneset e reja

Faqe 4
Ndryshimet në gjobat e rrugorëve ekspertët: Ja si do na rrjepë policia

Faqe 13
Arsimi ndryshon ligjin e rektorëve për të rikonfirmuar Dhori Kulen

[SHQIPTARJA.com]
LEKË 20
NR. 19 E premte, 25-11-2011

Tani jemi edhe online
www.shqiptarja.com

Fillimisht u lejuan të mos paguanin tatimin mbi vlerën e shtuar, por tani ndryshuan mendje

# GJOBE RRUGES SE KOMBIT

## Qeveria: S'paguan TVSH, detyrimi 2 mln USD

Kompania 'Bechtel Enka' ankohet te avokati i bizneseve. Tatimet: Ne duam detyrimin tonë. Ministri Bode para dy vitesh: S'mund t'i marrim gjobë shtetit

*Lajmi*

**Pas lejimit që të mos paguante TVSH-në fillimisht, tani qeveria është bërë pishman, duke i vënë një gjobë gjigande ndërtueses së segmentit rrugor "Durrës-Kukës"**

TIRANE

GENC KONDI

Burime nga Avokati i Tatimpaguesve bënë të ditur dje se kompania, që për tre vjet me rradhë ka shënuar xhiron më të lartë vjetore ndër gjithë VIP-at në vend, Bechtel-ENKA, ndërtuesi i "Rrugës së Kombit" është gjetur me shkelje për mospagim të detyrimit të TVSH-së dhe i është prerë një fletë gjobe në masën 2 milionë dollarë. Pasi u skualifikua këtë vit në tenderin për ndërtimin e segmentit Tiranë-Elbasan, ku përfshihet edhe tuneli, kompania merr kështu "shuplakën" e dytë brenda një kohe të shkurtër, pasi kishte qenë e privilegjuara e pushtetit ekzekutiv gjatë vitete kur ndërtoi segmentin Rrëshen-Kalimash.

Në atë kohë, ka qenë ministri Bode, i cili iu është përgjigjur akuzave të opozitës se shteti po hiqte dorë nga të ardhura të mëdha, duke i anuluar TVSH-në Bechtelit, me shprehjen se "nuk ka pse shteti t'i vejë taksë vetvetes".



Foto LSA

**Në foto:** Kryeministri Berisha, ish-ministri Basha duke shpërthyer tynelin e Kalimashit

Përballja dhe akuzat

Faqe 14-15

### Qosja në debat të ashpër në Kosovë

NGA ADMIRINA PEÇI

Shifra prej 200 milionë lekësh të reja është e konsiderueshme dhe pritet të kalojë në sistemin e ankesave, por këto kalojnë gjithnjë pranë Drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve, para se të përfundojnë në procese të gjata gjyqësore. Sipas Procedurave Tatimore, sidoqoftë, kompania duhet të paguajë një pjesë të mirë të gjobës, që të fitojë të drejtën ta ankimojë atë...

vijon në faqen 6

Analiza

NGA ARBEN MALAJ

## Pse një buxhet jorealist

Ekonomia është barometri më i mirë i mirëqenies dhe perspektivës tonë evropiane. Barra e borxhit mbi çdo shqiptar, papunësia, taksat që thellojnë pabarazinë si dhe ulja e mbështetjes për arsimin, shëndetësinë dhe solidaritetin social ndikojnë negativisht të ardhmen tonë. Debati mbi ekonominë dhe stabilitetin e financave publike për vitet e ardhshme është rritur. Po të analizojmë në mënyrë më të kujdesshme vëmë re disa faktorë që ndikojnë dukshëm gjendjen. Së pari – Kuvendi është duke diskutuar draft buxhetin e vitit 2012. Ky është moment i vështirë për shkak të debateve të tensionuara. Paralajmërimet për rrisqe në rritje po vijnë nga institucionet financiare ndërkombëtare, ato kërkojnë fillimin e masave parandaluese për të ndaluar përkeqësimin.

> Parashikimi i qeverisë se në 2012 do të mbledhë 26 miliardë lekë më shumë se 2011 është jorealist

Së dyti – mbyllja e vitit 2011 tregoi se ekonomia jonë është prekur më rëndë nga sa qeveria po pranon. Në vitin 2011 qeveria do të mbledhë në buxhet rreth 33 mld lekë ose 330 milionë dollarë më pak. Në 2011 qeveria do të mbledhë më shumë se në 2010 vetëm 5 miliardë lekë që rezultojnë në vlerë reale 5.5% më pak.

Së treti – Dy partnerët tanë kryesorë, Greqia dhe Italia janë përfshirë nga kriza. Kjo do të ndikojë rënien ekonomike në vendin tonë gjithashtu, pasoja, e para dhe më e rënda do të jetë vështirësia në mbledhjen e të ardhurave. Ndaj parashikimi i qeverisë se në 2012 do të mbledhë 26 miliardë lekë më shumë se 2011 është jorealist. Kjo rrit rriskun e mbledhjes abuzive të të ardhurave, do të ulet rimbursimi TVSH ndaj bizneseve dhe do të shtohen mospagesat ndaj kompanive private. Rrisku i fshehjes së...

vijon në faqen 7

DETAJET E REJA

Ekspertiza paraprake rrugore: Eduard Cani fajtor, jo Ledio Ruçi

### Aksidenti, vendimi i gjykatës: Minicooper kaloi me semafor të kuq

POLI HOXHA

Zbardhet i plotë vendimi gjykatës për masën e lirimit të djalit të deputetit socialist Gramoz Ruçi. Sipas këtij vendimi shtetasi Edi Lika, ka qenë fajtor determinant, sepse sipaz ekspertizës, rezulton të ketë qenë me semafor të kuq. Pavarësisht nga pretendimet e policisë, se ekspertiza nuk ka përfunduar akoma, prokurori që ndoqi çështjen e aksidentit të rëndë Blerim Tanushi, ka arritur në përfundim paraprak se fajtori i vetëm është...

Në faqe 9

GJYQTARI I VRARE

Shefi i Komisariatit: Vendimi u mor pas kërkesës së tyre

### Prindërit e gjyqtarit Konomi të rrezikuar, ruhen me policë te dera

VIOLA MURATI

Prindërit e Skerdilajd Konomit, gjyqtarit të vrarë në mënyrë mafioze në mes të qytetit të Vlorës, ndihen të kërcënuar, dhe për këtë, kanë kërkuar mbrojtjen nga forcat e policisë së qytetit të Vlorës. Lajmin e konfirmon për "Shqiptarja.com" shefi i komisariatit të policisë së Vlorës Alfred Elezi, i cili pohon se që nga data 1 tetor, shumë ditë në fakt pas vrasjes së bujshme të gjyqtarit Konomi, kanë kërkuar mbrojtjen nga forcat e rendit. Në shtëpinë e...

Në faqe 8




**AUTOSHKOLLAT**

**Ndryshimet në Kodin Rrugor kanë ngjallur reagimin e Shoqatës së Autoshkollave, e cila, si grup interesi, duket se nuk është pyetur fare nga ana e organeve shtetërore, për t'i marrë mendim. Sipas kryetarit të Shoqatës, Sokol Gogu, përfshirja e pajisjes me licensë në Qendrën Kombëtare të Licensimit është një hallkë burokratike, që sjell pengesa. Sipas Kodit, kjo licensë duhet të rinovohet çdo dy vjet**



**KRIZA NË RAJON**

**Një delegacion i Dhomës së Tregtisë së Selanikut ka mbërritur në Tiranë dhe ka zhvilluar dje takime në Dhomën e Tregtisë së Tiranës. Janë 50 biznesmenë të ndryshëm, të cilët do ta marrin pjesë edhe në panairin, e organizuar ngë Klik Ekspo Klik, që, të shtyrë nga vështirësitë në vendin e tyre, mendojnë të spostojnë një pjesë të biznesit në Shqipëri**

### Biznesi kishte kërkuar 10 muaj kohë për gjetjen e burimeve

# Ligji: Firmat VIP ta gjejnë vetë energjinë

## *Synimi, të hiqet monopoli, por nuk u jepet afat*

*Lajmi*

**Ligji, i bllokuar dje, për diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji elektrike, ka hasur në kundërshtimin e biznesit të madh, kryesisht investitorëve të huaj**

**TIRANE**

Genc Kondi

**Projektligji për disa ndryshime në sek torin e energjisë elektrike, që është prezantuar dje në seancë plenare të Kuvendit, nuk është hartuar duke marrë parasysh interesat e biznesit më të madh në vend,** investitorëve të huaj, që janë konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike. Ky draft kishte shkaktuar debate mes deputetëve të djathtë dhe të majtë që në komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Deputetët e majtë në komision kanë kërkuar që në lidhje me ndryshimet në ligj të merren parasysh grupet e interesit, ndërsa deputetët e mazhorancës kanë theksuar se kërkesa e grupeve të interesit është e vonuar. Kryetari i komisionit, Jemin Gjana, tha pak ditë më parë, gjatë diskutimit të draftit se hartimi i këtij projektligji është bërë në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian për sektorin e energjisë elektrike. Në këtë ligj, theksoi ai, kompanitë e mëdha duhet ta sigurojnë vetë energjinë elektrike dhe jo të furnizohen nga CEZ Shpërndarje.

**Por, përfaqësuesit e këtyre bineseve kanë kërkuar në Komision që të shtyhet me 10 muaj hyrja në fuqi e ligjit, derisa të krijojnë strukturat që të sigurojnë importin e energjisë.** "Në rast se ligji hyn në fuqi në fillim të janarit, ne detyrohemi të mbyllim aktivitetin", ka deklaruar Xhorxh Geha, përfaqësues i Cement Albania. Në të njejtën gjatësi vale ka qenë edhe drejtori i përgjithshëm i kompanisë turke të prodhimit të çelikut Kurum, Zeki Kaja.

**LIBERALIZIMI**

Projektligji për energjinë synon të krijojë kushte për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, duke e ndryshuar skemën aktuale të furnizimit me energji, veç klientëve tariforë, tarifat e të cilëvë rregullohen nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, do të pranohen edhe klientët e cilësuar si "të kualifikuar", që do të mund të zgjedhin në treg burimin e furnizimit të tyre me energji, nga furnizues të kualifikuar.

**Ndonëse ERE ka licensuar vitet e fundit disa klientë të kualifikuar, edhe këtë janë transformuar në klientë tariforë, që furnizohen nga CEZ Shpërndarje me energji elektrike që prodhohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare me tarifa të rregulluara.** Kjo është shoqëruar me rritjen shumë të madhe të kërkesës nga një operator i vetëm dhe, nga ky, në drejtim të KESH-it, sidomos dy vitet e fundit, gjë që, në kushtet e thatësirës së zgjatur të këtij viti, që ka çuar në minimume historike prodhimin nga Korporata, i ka krijuar asaj një "gropë të zezë" financiare, ndërkohë që edhe çmimet në tregun e jashtëm janë rritur së tepërmi.

**LICENSAT**

Me ndryshimet ligjore, synohet që konsumatorët e energjisë elektrike të lidhur me rrjetin 110 kilovolt e më lart se kaq të transmetimit të energjisë dhe ata që konsumojnë mbi 50 milionë kilovatorë energji në vit të konsiderohen si klientë të kualifikuar dhe të mund të furnizohen me energji elektrike në treg të lirë nga furnizues të kualifikuar.

**Aktyualisht, licensën e ERE-s e kanë vetëm shtatë shoqëri tregtare, të cilat mund të furnizojnë me energji elektrike klientët e kualifikuar, që janë biznese të mëdha.**

Pritet që, nga këto ndryshime, energjia e prodhuar nga hidrocentralet në vend me kosto të ulët të marrin më shumë energji konsumatorët e gjerë. Ndryshimet parashikohen të hyjnë në fuqi vitin e ardhshëm.

**TREGU**

Sipas ministrit të Energjetikës, Nasip Naço, ky projektligj është në ndihmë të konsumatorit, pasi me këtë mënyrë mund të shmanget rritja e çmimit, ndërkohë që do të shmangen ndërprerjet në furnizimin me energji.

**Në treg do të mund të hyjnë edhe operatorë të tjerë privatë, që do të sillte më shumë konkurrencë, uljen e kostos.** "Me këtë ndryshim, ne i heqim CEZ-it një barrë të rëndë për furnizimin me një vlerë monetare prej rreth 40 milionë eurosh në vit për KESH-in, si dhe eliminimin e borxheve të këqia nga klientët më të mëdhenj në vend.

**MONOPOLI**

Me këto ndryshime, gjithashtu eliminohet monopoli i furnizimit me energji elektrike, pasi diversifikohen operatorët në treg.

**Është parashikuar gjithashtu forcimi i rolit kontrollues të ERE-s, të cilës i jepen kompetenca të vendosë gjoba deri në 3 për qind të të ardhura të realizuara në vitin e mëparshëm një kompanie furnizuese**, e cila konstatohet se shkel rregullat e furnizimit.

Përfaqësuesit e këtyre bineseve kanë kërkuar në Komision që të shtyhet me 10 muaj hyrja në fuqi e ligjit, derisa të krijojnë strukturat që të sigurojnë importin e energjisë







**SOKOL OLLDASHI**

### "S'kemi militantë në Aviacionin Civil"

**Në debatin e djeshëm në Kuvend, deputeti i PS Eduart Shalsi ka deklaruar se në Autoritetin e Aviacionit Civil janë bërë emërime militantësh. "Aty ka një drejtor me diplomë mjeku dhe një tjetër drejtor nuk flet anglisht", deklaroi ai. Ministri Olldashi ka kundërshtuar, duke thënë se "drejtori nuk është specialist i fushës, por ai administron. Ai është profesionist. Nuk kemi shkollë aviacioni, specialistët i marrim nga jashtë dhe ata janë pesë". Sipas tij, akuzat e Shalsit janë politike.**



**? PYETJE PERGJIGJE**

■ **Biznesi duhej të ishte i interesuar ta gjente vetë burimin e furnizimit me energji elektrike. Pse ndodh e kundërta?**

Teorikisht, projektligji eliminon monopolin në tregun e furnizimit me energji elektrike. Ajo që shqetëson investitorët e huaj, që përbëjnë pjesën e ndërmarrjeve që konsumon më shumë energji se të tjerët - 800 milionë kilovatorë në vit - është koha e pamjaftueshme për të dalë në treg e për të gjetur operatorët e disponueshëm, deri në fund të këtij viti. Ata kanë kërkuar një shtyrje prej dhjetë muajsh për ta arritur këtë pa probleme financiare e teknike.

■ **Nuk parashikon ligji opsionin e zgjedhjes midis CEZ-it dhe një operatori tjetër?**

Ligji detyron subjektet që të dalin e të kërkojnë vetë operatorin, që do t'i furnizojë, për të lehtësuar CEZ-in që ky të ketë më shumë energji për të furnizuar klientët e vegjël



**NAÇO: BORXHI 50 MILINË EURO**

**Ministri Naço tha se kompania CEZ i ka KESH-it një borxh rreth 50 milionë euro, OST-së 20 milionë euro dhe të tjerë i kanë asaj rreth 20 milionë euro. Në ligj parashikohet që fatura e energjisë si "titull ekzekutiv" të përdoret edhe mes kompanive KESH, CEZ, OST në marrëdhëniet e tyre tregtare. "Vetëm titulli ekzekutiv për faturat e energjisë i zgjidh këto probleme", tha Naço. Për hartimin e P/ligjit "Për energjinë" një grup pune në METE punoi për disa muaj pasi vetë ligji përputhet me Direktivën e BE-së.**



**PS: TË MBROHET KONSUMATORI**

**Deputeti socialist Arben Ahmetaj pyeti se përse ky ligj që reklamohet nga qeveria në favor të konsumatorit dhe që do t'i japin fund klientelizmave dhe monopolit në sektorin energjitik nuk u hartua më parë, por u soll kaq vonë. "Vonimi i ligjit ka rënduar xhepat e qytetarëve, ka 7 vite që ky ligj nuk është në parlament", tha Ahmetaj. Ndërkohë Ministri Bode theksoi se ky ligj nuk është vonuar aspak. Sipas tij ligji i jep fund faturave afrofe e abuzimeve ndaj qytetarit të kompanive që menaxhojnë energjinë.**

## Dështon miratimi i ligjit për energjinë, sot votimi

# Shtyhet seanca, mazhoranca s'ka kuorumin, tetë deputetë mungojnë

## *Nuk kanë qënë prezentë Berisha, Bode Tafaj, Meta, Idrizi, Oketa, Sula e Bano*

### Lajmi

**Mazhoranca ka dështuar në votimin e ligjit për energjinë, pasi tetë deputetë të saj, mes tyre kryeministri Berisha, dy ministra, dy kryetarë partie aleate dhe tre deputetë të PD nuk kanë qënë në sallë për prezencë, duke mos plotësuar kuorumin e nevojshëm. Shtyhet për sot votimin.**

TIRANE

JAKIN MARENA

Mazhoranca ditën e djeshme nuk ka pasur numrat për të votuar projektligjin për energjinë, duke dështuar në këtë mënyrë që të votojë një ligj me shumicën e thjeshtë të votave. Kështu, nuk kanë qënë prezent në momentin e votimit kryeministri Berisha, Ministri i Financave, Ritvan Bode, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, kryetari i PDIU Shpëtim Idrizi si dhe deputetët e PD, Gazmend Oketa, Dashnor Sula dhe Ilir Bano. **Pikërisht mungesa e këtyre deputetëve, në krye të të cilëve spikaste kryeministrin i vendit, por dhe dy kryetarët e partive aleate në koalicionin e djathtë, bashkë dhe me tre deputetë të tjerë të PD, kanë sjellë dhe dështimin e këtij votimi, duke vënë në rrezik në mënyrë serioze mazhorancën e djathtë.** Ndërkohë që Ministri Bode ka braktisur sallën, me sa duket i nxehur me deputetët socialistë, Braçe, Ahmetaj, Malaj e Harasani, të cilët kanë qënë më aktivët dje në debatin për ligjin për energjinë. Kështu mazhoranca ka mbetur me 66 deputetë në sallë. Mungesën e kuorumit e ka bërë të ditur kryetari i Grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Gramoz Ruçi, teksa ka kërkuar pas miratimit të Kodit Rrugor dhe Kodit Ajror, 10 minuta pushim. Kryetari i grupit socialist ka konstatuar se në sallën e Kuvendit mungonin disa deputetë, duke rrezikuar kuorumin për të votuar projektligjin për energjinë, dhe vetëm votat socialiste mund ta bënin të vlefshëm këtë votim.

**MUNGESAT DJE NË VOTIM**

| Emri | Detyra |
|---|---|
| SALI BERISHA | Kryeministër i Shqipërisë |
| RITVAN BODE | Ministër i Financave |
| MYQEREM TAFAJ | Ministër i Arsimit |
| ILIR META | Kryetar i LSI-së |
| SHPËTIM IDRIZI | Kryetar i PDIU-së |
| GAZMEND OKETA | Deputet i PD-së |
| DASHNOR SULA | Deputet i PD-së |
| ILIR BANO | Deputet i PD-së |

**Ruçi ka kërkuar nga Topalli që të kthehen deputetët e mazhorancës në sallën e Kuvendit, në mënyrë që pastaj të bëhej kuorumi i nevojshëm dhe për pasojë dhe socialistët pastaj do të realizonin votimin e tyre. I menjëhershëm ka qënë reagimi i kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Astri Patozi. I cili i është rikthyer dhe njëherë opozitës, me akuzat e kahershme, duke nënvizuar se socialistët bëjnë si bëjnë dhe i rikthehen qëndrimit të kushtëzuar me Kuvendin.** Deklaratë e cila ka marrë reagimin dhe të deputetëve të tjerë socialiustë, të cilët bashkë me Ruçin kanë kërkuar nga mazhoranca që të bëjë kuorumin e nevojshëm për miratimin e ligjit për energjinë. Në debat është futur dhe kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli e cila ka nënvizuar se kuorumi është plotësuar, pasi prezenca në Kuvend sipas elektronikës thotë se është plot 229 deputetë, prezxan e votimit për dy kodet në fakt. Deklaratë e cila ka sjellë reagimin e kreut të grupit parlamentar të PS, Ruçi sipas të cilit deputetët socialistë nuk duhen të llogaritur pa u mbledhur kuorumi nga ana e mazhorancës, pasi do të heqin kartat.

**Kryetarja e Kuvendit, Topalli ka dalë nga situata e vështirë në të cilën është ndodhur dje mazhoranca nga mungesa e kuorumit, duke deklaruar se do të shtyjë votimin për ditën e sotme, kur dhe do të zhvillohet debati i gjatë për projektbuxhetin e shtetit për vitin 2012, një kërkesë sipas saj e bërë nga kreu i grupit të PD, pavarësisht se në fjalën e tij Patozi nuk e kishte artikuluar një kërkesë të tillë. Kështu, Parlamenti nisi dje seancën e radhës ku pritej të miratoheshin 2 pr/ligje.** Për miratimin e ndryshimeve të Kodit Ajror, palët pas disa orë debat gjetën konsensusin dhe dhanë votat pro për pr/ligjin që kërkonte shumicën e cilësuar. Debatet mazhorancë-opozitë, kishin të benin kryesisht për linjat ajrore të cilave iu pezulluan avionët dhe stafit të Autoritetit të Aviacionit Civil, shqetësime të ngritura nga PS. Gjuha me të cilën u debatua për Kodin Ajror, la fillimisht dyshime që mazhoranca dhe opozita nuk do të gjenin konsensusin, por në fund, deputetët bashkuan kartonat për t'i dhënë dritën jeshile zbatimit të ndryshimeve në ligjin për Kodin Ajror. Ndërkohë gjatë seancës së djeshme, pritej një interpelancë e ministrit të Punëve të Jashtme Edmond Haxhinasto, e kerkuar nga deputetja socialiste Arta Dade, por dhe kjo u shty, pasi Haxhinasto ndodhej për vizitë zyrtare në Vietnam.



## Opozita

# Ruçi: Nuk keni kuorumin, s'marrim pjesë në votim

TIRANE

Opozita është treguar e ashpër dje në Kuvend, teksa ka kërkuar me insistim plotësimin e kuorumit nga ana e mazhorancës, në mënyrë që të marrë pjesë në votimin e ligjit për energjinë. Ka qënë kreu i grupit parlamentar të PS, Ruçi ai që është shprehur se kishte kërkuar pushimin pas votimit të Kodit Ajror për të mos ndërhyrë. Ruçi ka nënvizuar se ashtu siç e kishte thënë në grup, do të përshëndeste punën dhe vullnetin politik që patën dy krahët e politikës për të kaluar ndryshime në Kod, duke marrë mendimet e dy grupimeve politike parlamentare. Ai ka garantuar se në qoftë se do të vazhdojë kjo për të gjitha reformat, natyrisht që PS është konstante në atë që ka thënë qysh në marrëveshjen që ka arritur. "E mora fjalën tani, që diskutohen këto dy projekt- ligje, se pati akuza të ndërsjella, që janë bërë lobime të ndryshme, nga kompani të ndryshme korruptive lidhur me këtë çështje. Sigurisht që ne do jemi në sallë, por nuk do jemi në sallë që të plotësojmë ata që mungojnë juve për kuorumin tuaj", ka deklaruar Ruçi. I cili nuk i ka kapërdirë akuzat e ministrit Naço për lobime për ligjin për energjinë. "Ndryshe të gjithë ato akuza që hodhët ndaj krahut tonë, atëherë lobimet ku janë bërë, tek kryeministri, që mungon, janë bërë tek ministri i Financave, janë bërë tek koalicioni që ju qeverisni Shqipërinë. Prandaj siguroni kuorumin tuaj, të vijnë të lobuarit këtu. Ndryshe ju nuk keni kuorum dhe ne nuk marrim pjesë në votim", deklaroi Ruçi.









## Ndëshkimet e Kodi njerëzit do të vetëpërmbahen

Eksperti Koxhaj thotë se e shikon edhe një anë të mirë te ndryshimet që janë bërë në Kodin Rrugor. Ai thotë se Kodi do ta rrisë sigurinë në rrugë, sepse njerëzit do të bëhen më të përgjegjshëm, përballë gjobave, do të tremben më shumë dhe do t'i thërrasin mendjes. "Në parim e pranojmë rritjen e gjobave, madje është e vonuar, por jo në këto nivele. Në Europë, u lihet diapazon policëve, por ata kanë një databazë, ku konsultohen me një drejtues mjeti në rrugë, se sa herë është gjobitur, sa herë i është hequr patenta, sa herë është përfshirë në aksidente rrugore. Pra janë një sërë rekordesh që të vendosë polici për gjobat pasi lexon tërë jetëshkrimin e një kundravajtësi, që vendos pastaj të vendosë maksimumin, apo minimumin e gjobës, në raport se kush është. Mbi këtë bazë, policia jonë nuk e ka këtë mënyrë kontrolli dhe abuzimi është krejtësisht i mundur"-thotë Koxhaj. Kodi që kaloi dje në Kuvend ishte propozuar nga qeveria në korrik 2010, duke parashikuar katërfishim të gjobave ndaj ndëshkuesve të rrugës. Por nga ana tjetër, ndërsa rrit masën e sanksioneve financiare, qeveria nuk ka siguruar rrugë me standarde dhe me sinjalistikë dhe në një vit rreth 400 njerëz vdesin nëpër aksidente.

### Ekspertët Gëzim Hoxha dhe Bert Koxhaj

# Kodi Rrugor gjobat: Ja si do të na rrjepë policia

## Nuk ulen aksidentet, duhet sinjalistika rregullimi i rrugës dhe zbatimi i rregullave

**Lajmi**

**Ekspertët e sigurisë rrugore janë kundër sanksioneve që parashikon Kodi i ri Rrugor, që kaloi dje me shumicë votash nga deputetët. Në intervistat e tyre për "Shqiptarja.com", ekspertët Gëzim Hoxha dhe Bert Koxhaj thonë se qeveria duhet të rregullojë infrastrukturën rrugore, pastaj të rrisë masën e ndëshkimeve, të cilat vetëm sa do të shtojnë korrupsionin në mes policëve rrugorë.**



Eksperti i sigurisë rrugore, Gëzim Hoxha

**VOTIMI**

### Kodi Rrugor merr 121 vota

**Ndryshimet në projektligjin e Kodit Rrugor, u votuan dje në Kuvend në seancë plenare, duke marrë një shumicë votash nga e majta dhe e djathta. Me 121 vota pro projektligji për Kodin Rrugor, bashkë me atë ajror, do të hyjë së shpejti në fuqi, duke parashikuar edhe shtimin e sanksioneve financiare ndaj kundravajtësve.**

TIRANE

ARBEN RROZHANI

Eksperti i sigurisë rrugore, Gëzim Hoxha thotë Kodi i ri Rrugor i kërkuar nga qeveria është veprim i njëanshëm, sepse shteti në fillim duhet të kishte plotësuar infrastrukturën rrugore, pastaj atë ligjore. Ai e konsideron gabim kalimin e Kodit, duke penalizuar të gjithë qytetarët, të cilët do të jenë në dorën e policëve rrugorë.

**Si e komentoni Kodin Rrugor dhe gjobat që ai parashikon?**

Më duket i gabuar, sepse kjo është si një tango që kërcehet dyshe, nëse jam unë pronari i mjetit dhe ti je pronari i rrugës, pra respektivisht Ministria e Transporteve për rrugët interurbane dhe bashkia për rrugët e veta. Këto të fundit, që të dyja, kanë detyrimin që ta vendosin rrugën në standard, sipas Kodit Rrugor, i cili nuk është libri i policit, që ai të bëjë si të dojë me të, por është kod që rregullon marrëdhëniet e qytetarëve me legjislacionin në tërësi. Në nenin 2 të Kodit Rrugor bëhet klasifikimi i rrugëve, pra ka lindur detyrimi që rrugën duhet ta kesh në këtë lloj standardi. Pra nëse je ti pronar nuk mund të bësh si të duash.

**Çfarë standardi kanë rrugët tona?**

Ato nuk kanë standarde fare. Po e shpjegoj me një segment rrugor, p.sh. nga Lushnja në Fier, aty ka tabela që të ndalojnë shpejtësinë. Nuk mund të ma pengosh mua shpejtësinë dhe ti duhet të më krijosh kushte që unë të qarkulloj me 80 km në orë. Unë dua që të më krijosh rrugën në standard. Në momentin që më ke vendosur tabelat, atje matanë më pret polici, i cili do të më vëndosë gjobën. Pra nuk mund të bësh si të duash ti dhe kush je ti. Pra i bie që të gjithë qytetarët të jenë të penalizuar. Unë u thashë deputetëve në komision që të ndiqja njërin prej tyre, privatisht, dhe t'ia filmoj të gjitha veprimet e tij dhe tia dorëzoj faturën në bazë të ligjit që po debatojmë tani dhe fatura mund të jetë 6 milionë lekë në fund të ditës. Ja po marr rrugën e Rinasit, p.sh, ku ka shumë rrugë që e ndërpresin rrugën në nivel, e cila ndalohet me Kod Rrugor. Nesër do të të filmojë radari dhe do të sjellë 7 fatura në qarkullimin rrugor dhe do të thonë që të paguash 1.2 milionë lekë pse ke thyer sinjalistikën rrugore. Unë them se shteti duhet të vendosë njëherë rrugën në standard dhe pastaj të rrisë tarifën e gjobave, për të ulur aksidentet. Aksidentet nuk janë vetëm çështje polici, sepse Kodi Rrugor nuk fillon në faqen 164, por në faqen 1. Qytetarët shqiptarë kanë bërë një marrëveshje: unë po bëj sikur po zbatoj rregullin, ti bëj sikur e rregullon rrugën.

**Do ta ulë numrin e aksidenteve futja në fuqi e ndryshimeve në Kodin Rrugor?**

Kjo nuk qëndron fare, sepse nuk është gjoba ajo që e rregullon këtë. Është faktori i sinjalistikës, rregullimit të rrugës, sepse po të zbatojmë këto rregulla dhe këto gjoba që kemi, këtu aksidentet nuk ndodhin. Por këtu nuk kemi ne, nuk zbatojmë këto që kemi, dhe nuk na gjobisin në masën që e parashikon ligji.

**Çfarë do të ketë në dorë polici rrugor sipas Kodit të ri Rrugor?**

Mua nuk më duket normale një diapazon i lirë nga 20 në 80 mijë lekë. Unë debatova sepse nuk mund të paguaj, që polici të më shikojë si të dojë. Pra nëse për 10 km më shumë shpejtësi unë do të gjobitem psh 30 mijë lekë, ndërsa kur e bëj 40 do të gjobitem kaq. Unë në fakt jam për ndëshkime drastike, për t'i futur në burg fare drejtuesit e mjeteve, në rastin se përdorin alkoolin, sepse ai nuk ka ndonjë hall, por pi raki dhe pastaj vret njerëz. Ose kur hipën me makinë në trotuar, është vepër penale me paramendim, sepse në trotuar ecin njerëzit, ose kur flet në telefon, duke të hequr vëmendjen.

Aspekti tjetër është ai që ne e kemi sinjalistikën copë-copë. Po të zbatosh sinjalistikën rrugore, për të shkuar në Sarandë të duhen rreth 11 orë. Unë e kam eksperimentuar, kur vija nga Saranda. Ua thashë edhe deputetëve në Kuvend. Një deputet më tha se unë e bënte rrugën Sarandë-Tiranë për 4 orë. I thashë se thyente rregullat dhe rrezikonte të thyente edhe kokën. Mua më ka dalë me matje shpejtësia 27 km/orë, kur karroca me kalë e ka 30 km/orë. Atëherë lind pyetja pse e blen makinën? Deputetët ma kthyen: "Po mirë të blejmë gomarë". U thashë: "Blini ç'të doni por po ju them çfarë ndodh".

### Masa e gjobës

# Eksperti Koxhaj: Shtohet oreksi i policisë

TIRANE



Bert Koxhaj, ekspert i sigurisë rrugore, i pranishëm në debatet e dy ditëve më parë në Kuvend, thotë se ndryshimet në Kodin e Rurgor vetëm sa do të shtojnë oreksin e policëve për korrupsion, duke mos ndikuar në uljen e aksidenteve. Në një prononcim për "Shqiptarja.com" ai pranon se ishte dakort me rritjen e gjobave vetëm dyfish dhe jo katërfish, sikundër u kërkua. "Ne e kemi kundërshtimin edhe nga ana parimore. Drafti që kishte paraqitur qeveria përfshin nja 17 nene dhe ne nuk ishim dakort me të, sepse nuk shoqërohej me motivacionin se çfarë pasojash negative ka sjellë në periudhën 1999-2011 kur ka vepruar Kodi aktual Rrugor dhe ata nuk arritën të na bindin pse e bëjnë këtë punë"-thotë Koxhaj. Ai shprehet i shqetësuar se rritja e vlerës financiare të gjobës për kundravajtësit do të rrisë korrupsionin, aktualisht shumë të lartë, në policinë rrugore. "Niveli aktual i organizatës së policisë, për përgatitjen profesionale, nivelin e korrupsionit dhe performancën e shërbimit vazhdon të jetë shqetësues. Vetë INSTAT publikoi para disa muajsh, që korrupsioni te policia rrugore, bashkë me mjekët, ishte 70 për qind, pra në nivelin më të lartë. Me Kodin e ri policëve do tu rritet oreksi dhe ky është një instrument që do të rrisë korrupsionin te policët që e kanë treguar se e kanë këtë ngasje prej lekëve nën dorë. Pra t'i japësh policit një instrument të tillë në dorë, që të vendosë për një shkelje në rrugë nga 20 në 80 mijë lekë, pa mekanizëm kontrolli them se prodhon efektin e kundërt"-shprehet I shqetësuar eksperti Koxhaj.

## Ndoka: Pragu i papranueshëm dhe përjashtues

**Kreu demokristian Nard Ndoka është shprehur kategorikisht kundër ngritjes së pragut elektoral në nivelin e 5 për qindshit, duke nënvizuar faktin se ky do të ishte kundër këtyre partive. "Pragu në sistemin proporcional është i panevojshëm, i papranueshëm dhe përjashtues. PD kërkon të qëndrojë në pushtet duke deformuar Kodin dhe duke vjedhur votat", ka qënë deklarata e demokristianit Ndoka. Duke evidentuar faktin se tryeza e përbashkët e partive politike, përfshirë dhe pesë parti të mazhorancës kishte vendosur një paketë propozimesh, në formë kushtesh për dy partitë e mëdha, mes të cilave dhe ndryshimin e sistemit proporcional rajonal për ta bërë me korrektim kombëtar si dhe prasgje të ulta, Ndoka nënvizoi se këtë propozim do ta mbronin me forcë, pasi kanë dhe mbështetjen e PS dhe të kreut të saj, Rama. Pra janë të gjitha partitë në njërën anë, dhe PD mbetet e vetme në anën tjetër. Asnjë nga partitë politike, veç PD dhe PS nuk arrin dot këtë prag kombëtar, duke bërë që të gjitha këto parti, ose të jenë në listat e përbashkëta me ato të PD dhe PS ose të zhduken nga skena parlamentare politike dhe duke e kthyer Parlamentin një një dypolaritet të pastër.**

### Qëndrimi i deputetit të PD: Duhet qeveri stabël dhe kjo sigurohet me vendosjen e pragut

# PD: Prag elektoral mbi 5 për qind

### Shehu: Sistem proporcional rajonal me korrektim kombëtar dhe prag 5%, sistem proporcional i pastër kombëtar me prim ose sistemin proporcional rajonal që që kemi

*Lajmi*

**Demokratët janë të bindur se nëse kërkesa e partive të vogla për proporcional rajonal me korrektim kombëtar pranohet, atëherë do kemi qeverisje jo stabël. Për ta, sistemi duhet ose proporcional i pastër kombëtar me prim, ose proporcional rajonal me korrektim kombëtar, por me prag 5%, ose sistemi aktual**

TIRANE

JAKIN MARENA

Demokratët dalin me një element të ri në prag të fillimit të punës të komisionit për reformën zgjedhore, i ngritur një javë më parë nga Kuvendi i Shqipërisë me konsensusin e mazhorancës dhe opozitës. Ata janë dakord për ndryshimin e sistemit zgjedhor, nga proporcional rajonal në rajonal me korrektim kombëtar, por me kushtin e vetëm që pragu elektoral të ngrihet në 5 për qind. Pasi sipas PD, do të garantonte një qeverisje stabël. "

**Një sistem zgjedhor, që të jetë i efikas duhet që të jetë demokratik, dhe të përfaqësojë votën e elektoratit, duke siguruar në këtë mënyrë një stabilitet në qeverisje. Sistemi zgjedhor proporcional rajonal me korrektim kombëtar vërtetë sjell përfaqësimin real të votuesit përmes mandateve në Kuvend, por ama nuk sjell një qeverisje stabël", ka qënë deklarata e djeshme e anëtarit të Këshillit Kombëtar të PD, deputetit Tritan Shehu për gazetën tonë.** Ai shprehet njëherësh se stabilitetin e një qeverisjeje e sjell ose një sistem me proporcional i pastër kombëtar, ose me korrektim kombëtar dhe prag elektoral prej 5 për qind. "Stabilitetin në qeverisje e sjell një proporcional i pastër kombëtar që të jetë si në vendet e BE me prim, ku partia e parë, sipas një keoficienti të caktuar merr shtesë deputetësh për të formuar mazhorancën dhe për pasojë dhe një qeverisje stabël", deklaroi Shehu.

**Për të cilin, pranimi i kërkesës së partive të vogla që të ketë sistem proporcional rajonal me korrektim kombëtar, t'i shtohet dhe pragu i lartë elektoral, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të qeverisjes.** "Jemi ddakord që të ndryshohet sistemi proporcional rajonal, duke e bërë me korrektim kombëtar por duke vënë një prag elektoral prej 5 për qind. Pikërisht kjo do të forconte stabilitetin e qeverisjes, për secilën forcë politike apo koalicion zgjedhor që fiton zgjedhjet parlamentare të radhës. Votat e partive të vogla që nuk arrijnë këtë prag u shpërndahen partive fituese", ka deklaruar ai. Sipas deputetit demokrat, nëse veprohet sipas kërkesës së partive të vogla, me sistem proporcional rajonal me korrektim kombëtar dhe me prag të ulët, atëherë do të kishim qeveri njëherë në dy muaj, si gjatë kohës së qeverisjes së demokristianëve në Itali.



Tritan Shehu

"Jemi dakord që të ndryshohet sistemi proporcional rajonal, duke e bërë me korrektim kombëtar por duke vënë një prag elektoral prej 5%".

**Shehu mendon se përfundimisht korrektimi kombëtar nuk jep një qeverisje stabël në Shqipëri dhe mendimi i tij është që ose të ruhet ky sistem që kemi tani, ose duke shtuar korrektimin kombëtar, të shtojmë dhe pragun prej 5 për qind. "Mendoj se ato që do të vendosin do të jenë dy partitë e mëdha, të cilat në komision do të bëjnë dhe balancën për efikasitetin e sistemeve, duke vendosur për pozitivitetin apo negativitetin e secilës palë.** Pavarësisht kërkesave të partive të vogla, janë partitë e mëdha ato që e kanë përgjegjëesinë e vendimit", deklaroi Shehu. Ndërkohë që deputeti Shehu, në lidhje me kërkesat e tjera të partive të vogla, që janë administrata zgjedhore apolitike, votimi elektronik, madje dhe vota e emigrantëve, është shprehur pro tyre, duke deklaruar se për këto elementë mund të arrihet akordi.

PAVARËSIA

## Obama Topit: Mbështetje për integrimin

**Presidenti amerikan Barak Obama uroi homologun e tij Bamir Topi dhe të gjithë popullin shqiptar me rastin e Ditës së Pavarësisë. Përmes një mesazhi të dërguar në adresë të presidentit Topi, kreu i Shtëpisë së Bardhë nënvizon përkushtimin e SHBA-ve për të mbështetur përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE. Presidenti amerikan ka nënvizuar faktin se SHBA është krenare që qëndrojnë krah për krah me Shqipërinë në Afganistan. Qeveria amerikane vazhdon të mbështesë fuqimisht përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE", thuhet në mesazh.**

SHQETËSIMI

## Financimi i partive, TI: Gjeni burimin

**Në raportin rajonal të financimit të partive politike të prezantuar dje në Zagreb, Transparency International, vëren se financimit të partive politike në Shqipëri, Kroaci, Kosovë, Maqedoni e Serbi, i mungojnë masa të forta transparence mbi deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre. "Deklarimi publik i financimeve të partive politike duhet të forcohet më tej me afate kohore të qarta dhe mekanizma realë të publikimit në Shqipëri dhe Kosovë", thuhet në raport.**

### Rama, takim me Fylen:

# "Frikë mos vidhen sërish zgjedhjet"

TIRANE

Për të avancuar në procesin e integrimit në BE është thelbesore që të gjitha forcat politike në vend ta kthejnë atë në axhendë kombëtare". Apeli vjen nga Komisioneri për Zgjerim në KE Stefan Fyle, gjatë takimit të zhvilluar dje në Bruksel me kreun e PS-së, Edi Rama. Në faqen zyrtare të Komisionit Europian thuhet se takimi i djeshëm i Ramës me Fylen ishte pjesë e kontakteve të rregullta me forcat politike shqiptare në kuadrin e marrëveshjeve të fundit për reformën zgjedhore, parlamentare dhe votimet e ligjeve me 3/5. Fyle shprehu vlerësimin e tij për rolin që PS është gati të luajë për të mbështetur perspektivën europiane te vendit. Ndërsa kreu socialist Rama është shprehur se në takimin me Fylen se u bë një bilanc të kësaj pune që ka sjellë një moment të ri politik. "Nënvizuam vullnetin tonë që të japim kontributin që na takon në aspektet që përgjegjësia është e përbashkët dhe ku opozita ka një rol të patjetërsueshëm. Theksuam shqetësimet tona lidhur me të gjithë atë pjesë tjetër të konsiderueshme të prioriteteve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë e qeverisë", tha Rama. Nga ana tjetër, Rama tha se morën inkurajim dhe mbështetje për të vazhduar në këtë proces për të dhënë gjithçka mundemi që procesi të jetë sa më përmbajtësor dhe që rezultatet e tij të jenë të dukshme dhe të prekshme. "Ne hyjmë tek skeptikët dhe nuk kemi asnjë arsye të besojmë që pala tjetër ka vullnet që këtë herë të mos ta kthejë gjithë këtë proces në një kurth të ri që të përfundojë me një palë tjetër zgjedhjesh të vjedhura", shprehur frikën e tij Rama. Duke nënvizuar se u takon të bëjnë gjithçka munden me besimin që sensibilizimi shumë i lartë i komunitetit ndërkombëtar dhe përkatësisht i BE lidhur me çka është e domosdoshme sot për t'u kapërcyer do të jetë një ndihmesë shumë e madhe që e shkuara të mos përsëritet. "Të mos harrojmë që kemi një raport të ODIHR që ndryshe nga raporti i zgjedhjeve të 2009, është i qartë, i troçtë dhe nuk lë vend për ekuivok", tha Rama.



Stefan Fyle dhe Edi Rama

## Sigurohen financime për by-pass-et Vlorë e Fier

**Është nënshkruar dje në Tiranë marrëveshja midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim lidhur me kreditimin e 53 milionë eurove, për financimin e by-pass-eve të Fierit e Vlorës. Vlera për objektin në Fier është rreth 70 milionë euro, nga të cilat BERZH-i ka rënë dakord të financojë me kredi të butë 35 milionë. Pjesa tjetër do të financohet nga BEI, Banka Evropiane e Investimeve. Ndërsa by-pass-i i Vlorës kap vlerën prej 54 milionë eurosh, nga të cilat 18 milionë euro do të kreditohen nga ana e BERZH-it. Kredia është me afat 15-vjeçar shlyerjeve dhe me terma të butë. Ajo do të fillojë të shlyhet vetëm pas tre vitesh, nga disbursimi. Gjatë këtij viti, në Shqipëri BERZH-i ka financuar në total fonde me vlerë prej 95 milionë eurosh, që përbën edhe shifrën më të madhe të investuar gjatë një viti të vetëm në një vend të vetëm, theksoi drejtori i BERZH-it për Evropën Juglindore, Marc Peterschmidt. Delegacioni i BERZH-it pati edhe një takim të veçantë me kryeministrin Berisha.**

### Tatimet kërkojnë 200 milionë lekë të reja për shkelje

# Qeveria gjobit edhe ndërtuesit e "Rrugës së Kombit"

## *Kompania amerikano-turke ndëshkohet për mospagim të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar*




Berisha, Basha dhe Bode gjatë ceremonisë së nënshkrimit të kontratës me 'Bechtel&ENKA'

TIRANE

GENC KONDI

*vijon nga faqja 1*

... Kompanisë Bechtel, pas së cilës qendronin autoritete shtetërore amerikane, i janë bërë të gjitha privilegjet e mundshme deri tani nga ana e qeverisë Berisha. Asaj i është kërkuar zyrtarisht që, madje, të shkelë edhe rregullat teknike për të përfunduar para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009 tunelin, gjë që u arrit, por mes protestave të drejtuesve teknikë të kompanisë. Dukej se Berisha ishte i gatëshëm të paguante çdo çmim për realizimin e këtij segmenti, duke filluar nga tarifa shumë të larta të njohura nga shteti për koston e ndërtimit, nga materiale ndërtimore disa herë më të shtrenjta se në tregun e lirë. Por, pas mbarimit të rrugës, tani ka dalë në pah një tjetër problem: mirëmbajtja, e cila ka një kosto prej disa milionë eurosh në vit. Sipas kontratës, edhe për dy vjet pas mbarimit të punimeve, do të jetë Bechteli që do të përgjigjet për mirëmbajtjen, por nuk dihet në se janë akoma në fuqi apo jo këto klauzola.

**Ndërkohë, ka qenë vetë kryeministri, i cili, pasi mohoi** për shumë kohë dhënien e rrugëve me koncension, pranoi, në maj të këtij viti, se në rrugët nacionale, duke filluar nga ajo Durrës-Kukës, Tiranë-Fier, etj, së shpejti duhet të vendosen "trarët". Pra, për të kaluar në to, çdo automjet do të detyrohet të paguajë një tarifë të caktuar, në vartësi të kilometrave të përshkuaara apo tonazhit të një automjeti. Këtë lajmërim e bëri vetë kryeministri Berisha, në mbledhjen e rradhës të Këshillit të Ministrave.

**"Zoti minister i Punëve Publike, - iu drejtua ai Olldashit** - në katërvjeçarin që shkoi u ndërtua vepra më e madhe publike në historinë e këtij vendi. Ne e ndërtuam atë, por atë e ndërtoi 'Bechtel&ENKA'. Ky vend nuk ka kapacitete publike për mirëmbajtjen e saj", deklaroi kryeministri.

**Shteti shqiptar ka vendosur kështu të penalizojë edhe** më të privilegjuarën ndër kompanitë e huaja, që, sikurse e pranoi Berisha, ndërtoi rrugën më të rëndësishme në planet e qeverisë. Por, sikurse shton ai, "ne e ndërtuam atë", pavarësisht se "e ndërtoi Bechteli". Pra, shteti mban të drejtën e gjobitjes, sidomos pasi ka kuptuar se çfarë shpenzimesh ka bërë në të vërtetë për këtë rrugë dhe cilat janë pasojat e borxheve, që u morën për të, tani, kur e gjithë bota është në krizë dhe bankat kërkojnë shifra të mëdha për kamatat e kredive tregtare, të marra me shpejtësi vitet e kaluara. Janë këto kredi, që ndikuan kryesisht në rritjen e borxhit publik të vendit shumë pranë kufirit ligjor të 60 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, shifër, që, sipas ekspertëve të ndryshëm, është tejkaluar me kohë. Kjo masë drastike, ndoshta, paralajmëron një valë gjobash për të plotësuar të ardhurat buxhetore, që po pakësohen muaj pas muaji.

KOSOVË

### "Rruga e kombit", kritika edhe më tej

**Segmenti kosovar i "rrugës së kombit" ka ngjallur reagime edhe në Kosovë, midis subjekteve politike, lidhur me lëshimet, që i janë bërë kompanisë "Bechtel" edhe këtu, sidomos përsa u përket çmimeve të blerjes së materialeve e lehtësive të tjera. Kontrata me shoqërinë ndërtuese është bërë publike në parlamentin e Prishtinës, ku është konstuar se në të nuk ka asnjë lloj çmimi fiks dhe se ajo varjon në bazë të çmimeve për njësi. Kjo praktikë u përdor edhe në Shqipëri. "Bechtel" sipas kontratës merr 40 milionë euro pagesë fillestare, vetëm për të sjellë makinerinë në Kosovë, dhe më pas, për amortizimin e kësaj makinerie, ajo merr për çdo muaj nga një milion euro, si dhe pagesë shtesë për ta kthyer makinerinë në vendin e vet.**

### PYETJE PERGJIGJE

**Përse penalizohet një kompani, e cila u tha se përjashtohej nga detyrimi për TVSH-në, vite më parë?**
Edhe në rast se është thënë ashtu në fillim, fjala ishte për një lëshim të përkohshëm, në mënyrë që t'i jepej mundësia Bechtel-Enkës që të kishte më shumë likuiditete për të siguruar një punë të shpejtë

**Shteti ishte investitori në këtë objekt, pse duhet të merret edhe TVSH-ja, që i shkon prapë shtetit?**
Sado absurde të duket, kështu funksionon sistemi i taksimit në ekonominë e tregut, ndryshe krijohen hapësira për shtrembërime. TVSH-në e paguajnë edhe ndërmarrje shtetërore, si dhe institucione shtetërore në marrëdhëniet me njeri-tjetrin. Ajo është pjesë e kostos së një projekti apo malli

**Është treguar jokorrekte Bechtel në pagesën e taksave ndaj shtetit shqiptar?**
Ky është rasti i parë që merret vesh një gjë e tillë. Në fakt, shteti e ka favorizuar atë në shumë drejtime, kështu që çdo shkelje do të ishte një absurditet, por tatimet kanë databasen e tyre dhe vështirë që të jenë gabuar

### Panairi

# Topi, takim me biznesmenët

TIRANE



Presidenti i Republikës, Bamir Topi, priti dje në selinë e Presidencës në një takim të veçantë përfaqësues të kompanive nga Greqia, Serbia, Hungaria, Gjermania, Italia, etj, që marrin pjesë në panairin e XVIII Ndërkombëtar të organizuar nga "Klik Ekspo Group". Ky panair do të zhvillohet më 25-30 nëntor në mjediset e Pallatit të Kongreseve në Tiranë. Pas u uroi mirëseardhjen biznesmenëve të huaj, kreu i shtetit nënvizoi rëndësinë e organizimit të veprimtarive të tilla, pasi ato kontribuojnë në evidentimin e bizneseve të sipërmarrësve shqiptarë dhe në shpalosjen e strategjive të tyre të marketingut, si dhe në ekspozimin e produkteve, teknologjive dhe planeve të investimit të sipërmarrësve të huaj në tregun shqiptar, sepse njerëzit e biznesit nuk duhet të njohin kufij.

**Gjithashtu, Presidenti Topi vlerësoi përpjekjet e suksesshme** dhe iniciativat e mëdha të sipërmarrësve shqiptarë në 20 vitet e demokracisë dhe organizimin e përvitshëm të panaireve, që, në këtë mënyrë, japin një ndihmesë më konkrete dhe më e drejtpërdrejtë për të rritur bashkëpunimin mes bizneseve vendase e të huaja, për të promovuar investimet në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare, e cila ofron mundësi të shumta në infrastrukturë, energjetikë, turizëm, etj, duke patur një qendrueshmëri politike, ekonomike dhe lehtësira fiskale. Sipërmarrësit e huaj vlerësuan arritjet e Shqipërisë dhe u shprehën se Panairi edhe sivjet do të rritë investimet e huaja.



**DEPOZITAT BANKARE**

**Kriza në Greqi nuk rrezikon bankat greke në Shqipëri. Garancia vjen nga kreu i Shoqatës së biznesit grek, njëherësh drejtues i një prej bankave me kapital grek në Shqipëri. Andreas Galatulas deklaroi dje se depozitat e shqiptarëve në katër bankat greke në Shqipëri janë të sigurta dhe çdo veprim i tyre mbikëqyret dhe monitorohet nga Banka e Shqipërisë. Këto deklarata u bënë gjatë forumit të pestë të biznesit shqiptaro-grek**



**TAKSAT VENDORE**

**Ligji për faljen e detyrimeve doganore, tatimore, detyrimeve të prapambetura, si dhe kamatëonesave të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore përfshin edhe tarifat e qytetarëve pranë njësive bashkike. Zëvendësministri i Financave Alfred Rushaj deklaroi dje se në këtë falje përfshihen tarifat e papaguara nga qytetarët pranë njësive bashkiake, të njohura si taksa e gjelbërimit, apo ajo e pastrimit deri në fund të vitit 2010.**

### Kompania ka 13 muaj që nuk paguan

# ERE: CEZ -i KESH-it e OST 78 milionë euro

*Lajmi*

**Edhe Enti Rregullator i Energjisë Elektrike ka marrë dje anën e KESH-it, pas ankesave, që Korporata ka bërë për një borxh shumëmiliardësh, që i detyrohet CEZ-i**

TIRANE

Genc Kondi

Drejtori juridik i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, Eduard Elezi, deklaroi dje se kompania private e shpërndarjes së energjisë elektrike në vend duhet të paguajë të gjithë borxhin, që i ka Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, prej 58 milionë eurosh. Sipas tij, këtu nuk është fjala për një debi të trashëguar, por për një borxh të ri, të krijuar nga CEZ-i ndaj KESH-it, që nga koha kur është privatizuar shërbimi i shpërndarjes së energjisë elektrike.

**Nga ana tjetër, drejtori u ka bërë thirrje** qytetarëve që të përdorin hapësirat, të cilat iu njeh ligji për energjinë elektrike, duke u drejtuar për ankesat e tyre pranë Entit Rregullator, në ato raste, kur konstatojnë mbifaturime të energjisë nga ana e CEZ-it.

**Sipas tij, këto ankesa pranë ERE-s janë** shtuar së tepërmi muajt e fundit.

**Edhe KESH-i sqaroi se CEZ i detyrohet 58 milionë** euro borxh, të krijuar që nga dhjetori i vitit 2010 dhe në vijim. Mosshlyerja e borxhit nga CEZ i ka krijuar vështirësi financiare KESH-it, i cili u ka borxh bankave shumën prej 70 milionë euro, të cilat i ka marrë për të blerë energji jashtë vendit, në kushtet kur thatësira ka ulur dukshëm nivelin e ujrave në liqenet e kaskadës së Drinit. Borxhi prej 58 milionë euro që kompania CEZ i ka KESH-it nuk është trashëguar




dhe as është krijuar nga koha kur sektori i shpërndarjes së energjisë ishte në varësi të shtetit (ish-OSSH), thanë burime nga Korporata, Sipas tyre, "kjo shumë, bashkë me kamatëvonesat, ka arritur në vlerën rreth 58 milionë euro dhe është e njohur nga CEZ-i, pasi ka nisur të krijohet si borxh që nga muaji nëntor 2010 e në vijim". Kompania CEZ ka 13 muaj që nuk e paguan energjinë që merr nga KESH-i për të furnizuar konsumatorët, sipas kontratës së lidhur mes dy kompanive.

**KESH po importon aktualisht energji, duke** përdorur 45 milionë euro overdrafte, përmes të cilave ka garantuar blerjen e energjisë elektrike sipas kërkesës së CEZ-it për për të furnizuar pa ndërprerje konsumatorët. "I vetmi klient që KESH ka është CEZ dhe si rrjedhim, shlyerja e detyrimeve prej saj ka rëndësi jetike për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare", thanë burimet zyrtare të Korporatës.

**Gjithashtu, KESH ankohet dhe për faktin që CEZ-i** nuk ka bërë planifikim të saktë të konsumit të energjisë mbi bazën e statistikave shumëvjeçare, kusht që e kërkon edhe modeli i tregut të energjisë. Në fillim të vitit, CEZ kërkoi 4,3 miliardë kilovatorë energji për furnizimin vjetor të konsumatorëve në Shqipëri, ndërsa sot ky furnizim arrin në vlerën 5.2 miliardë kilovat-orë, ose me 900 milionë kilovatorë shtesë mbi planifikimin fillestar, të cilin e ka përballuar KESH-i për sigurimin e energjisë për të furnizuar CEZ-in.

**Gjithashtu, ERE vuri në dukje dje edhe një fakt** tjetër: Kompania CEZ i detyrohet edhe kompanisë publike të transmetimit OST borxhin në vlerën prej 20 milionë eurosh, çka rrit totalin e detyrimeve ndaj të tretëve në 78 milionë euro, ose afro 11 miliardë lekë të reja.

KRIZA

## Mbyllet hipermarketi gjerman Praktiker

**Hipermarketi i parë që hyri në vendin tonë me produkte për shtëpinë dhe punën, Praktiker, ka vendosur të mbyllë aktivitetin në Shqipëri. Agjencia Reuters konfirmoi dje lajmin, duke pohuar se kompania-mëmë Praktiker në Gjermani ka vendosur, në kuadrin e një reforme, të ndikuar nga kriza ekonomike që ka përfshirë Evropën, të ndërmarrë mbylljen e Praktiker Shqipëria dhe disa hipermarketeve të tjera. Praktiker tha se do të ndërpresin veprimet në Shqipëri, si dhe do të rishikojnë operacionet e tjera ndërkombëtare të kompanisë.**



ANALIZA

Nga ARBEN MALAJ

## Pse një buxhet jorealist

*vijon nga faqja 1*

...deficitit dhe borxhit do të rritet, duke ua kaluar kompanive private krizën e borxheve, si mungesë likuiditeti dhe shtim të kredive të këqia të tyre ndaj bankave.

Së katërti - Të unifikuar tre institucione financiare ndërkombëtare, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, po bëjnë parajamërime serioze mbi pasiguritë e ekonomisë sonë, duke filluar me një rënie më të madhe të rritjes ekonomike në 2012. Nëse qeveria pretendon se në 2012, rritja ekonomike në vendin tonë do të jetë rreth 4.5%, ato parashikojnë një rritje ekonomike në opsionin më të optimiste të tyre jo më shumë se 2.5% dhe në variantin më pesimist jo më shumë se 1.5% GDP. (referencat IMF, ËB, BERZH)

Së pesti - një studim fundit i BB për sfidat e vendeve të rajonit tonë, hedh poshtë me argumenta dhe shifra faktin se ekonomia shqiptare ndodhet në një situatë më të mirë se gjithë vendet e tjera të rajonit. Ekspertët e BB argumentojnë se qëndrueshmëria e financave tona publike është më e ekspozuar se vendet e tjera të rajonit ndaj riskut të krizës.

Disa elementë konkrete të analizës për risqet në rritje ndaj stabilitetit të financave tona publike dhe për domosdoshmërinë e përgjegjësisë politike e publike, tani dhe jo më vonë, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të stabilitetit të financave publike janë:

1.Vendi ynë ka borxhin më të lartë nga të gjitha vendet e rajonit. Mesatarja e borxhit publik në vendet e rajonit është 38.6 % e PBB ndërsa në vendin tonë rreth 60% ose 55 % më i lartë.

2.Kemi borxhin më të lartë në raport me të ardhurat që mbledhim në buxhet. Në vendet e rajonit tonë borxhi është 1.1 herë më i madh se të ardhurat buxhetore, në Shqipëri borxhi është 2.3 herë më i madh, ose dy herë më shumë/keq se mesatarja e tyre.

3. Kemi koston më të rëndë në fiancimin e borxhit publik, e cila është 3 herë më e lartë se kostoja me të cilën financojnë ekonominë e tyre vendet e rajonit. Kriza po thellohet me përfshirjen e disa vendeve të eurozonës. Kjo rrit vështirësitë e hua-marrjes dhe sidomos koston e saj. Ky risk nëse nuk ne nuk ulim borxhin do ti afrohet edhe ekonomisë tonë, ç'ka do të impononte paketa shtrënguese të menjëhershme dhe me të efektshme sociale të ndjeshme.

4.Ne kemi hapësirën më të vogël për të manovruar me investime shtesë apo ulje taksash. Kur borxhi i vendeve të tjera është 38% ata kanë mundësi të investojnë në ekonomi pa dëmtuar ndjeshëm stabilitetin e financave, ndërsa në vendin tonë nëse 2012 ka një risk për rritje subvencionesh në energji, ose nëse rritja ekonomike ulet ndjeshëm, ndërhyrja me investime publike bëhet e vështirë dhe e kushtueshme. Ja pse rekomandohet që kur vendi ka rritje ekonomike të ketë një borxh publik sa më poshtë niveleve kritike, që të ketë mundësi të ndërhyjë jo duke zmadhuar ortekun e borxheve dhe kostove të tij.

5.Ne kemi vleresimin më të dobët lidhur me garancinë për bonot e thesarit, (veç Bosnje Hercegovinës dhe Kosovës). Kjo do të thotë ata që blejnë borxhin tonë duan norma më të larta fitimi, i cili i ngarkohet kostos se financimit per buxhetin dhe biznesin. Në kushtet qe duhet të ulim deficitin, në kushtet kur rrezikohet dhe rënia e të ardhurave, çdo rritje e interesave, do të imponojë shkurtime buxhetore, ku sektorët e arsimit, shëndetësi dhe mbrojtjes sociale do të goditen më rëndë. Mbështetja për arsimin dhe shëndetësinë që tani ka mbritur në nivele kritike.

Për të gjitha këto arsye, dhe për impaktin pozitiv, social dhe politik, që sjell parandalimi i përkeqësimit të situatës, ne duhet të marrim përgjegjesinë e marrjes së masave konkrete duke filluar nga buxheti 2012.

Fshehja e situatës kritike dhe shtimi i akuzave ndaj opozitës nuk e ndihmon qeverinë për të ulur shqetësimet reale dhe risqet në rritje. Ndaj edhe të gjitha institucionet ndërkombëtare dërgojnë të njëjtin mesazh dhe me më shumë forcë, tani dhe jo me vonë.

Opozita shqiptare nuk kërkon të krijojë krizë, nuk kërkon të rrisë artificialisht shqetësimet, nuk kërkon të fillojë të kapitalizojë mundësitë e fitores së saj mbi dështimin e ekonomise shqiptare.

Opozita shqiptare nuk është kundër biznesit të vendit të saj, nuk kërkon të godasë biznesin dhe sipërmarrjen, pasi është e qarte se sfidat tona të së ardhmes, janë të mundshme vetëm nëse mundet frika, ulet deficiti e borxhi dhe ushqehet më mirë me reforma, rritja ekonomike e vendit.

Recetat teknike të paketave parandaluese janë të qarta. Vonesat e marrjes së angazhimeve dhe përgjegjësive të përbashkëta për të ardhmen e vendit tonë, janë të pa justifikueshme. Duhet të rrisin sensibilitetin publik kundër vonesave, duhet të reduktojmë frikën dhe pasigurinë sepse ato shumëfishojnë impaktet negative mbi ekonominë.

Të parandalojmë përkeqësimin në ekonomi, jo duke përkeqësuar zhvillimet politike, por duke rritur përgjegjësite tona politike dhe detyrimin ndaj vendit tonë.

Sa më shpejt aq më mirëk, sa më vonë aq më e vështirë situata, e aq më të thella pasojat negative të dështimeve tona.

Duke mbështetur një rritje reale ekonomike dhe një ndarje më të mirë të përfitimeve të rritjes ekonomike midis grupeve sociale, duke synuar një rritje ekonomike të qëndrueshme, cilësore dhe me rritme të larta, sfidat tona të uljes së papunësisë, të reduktimit të varfërisë dhe të rritjes së stabilitetit të financave publike janë të mundura.



### BERAT, BURRI PLAGOS GRUAN SHTATËZËNË

**Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmë në qytetin e Beratit. Nerenxa Meçe shtatzënë, është qëlluar disa herë më thikë nga bashkëshorti i saj dhe gjendet në gjendje të rëndë në spital. Policia është në kërkim të autorit, i cili ka ikur menjëherë nga vendngjarja. Sipas policisë, krimi në familjen Meçe ka ardhur si pasojë e grindjeve të shpeshta që çifti ka pasur kohët e fundit mes njëri tjetrit. Rrethi i Beratit gjatë viteve të fundit është në krye të statistikave për krime në familje.**



### SELANIK, KAPET ÇIFTI SHQIPTAR ME DROGË

**Dje rreth orës 18.00, agjentët e antidrogës greke në qytetin e Selanikut, kanë prangosur në flagrancë një çift shqiptar, i cili po transportonte një sasi të konsiderueshme droge. Atyre u janë kapur në bagazhet e tyre 1 kilogram drogë e llojit të fortë, heroinë dhe 3.1 kilogram kanabis. Policia greke për arsye hetimi nuk jep emra, por thekson se ata përdornin për maskim edhe 2 fëmijët e tyre të vegjël. Operacioni u kry pas një kohe të gjatë përgjimesh që policia greke bënte për çiftin.**

## Pas apelit të familjarëve për pronat dhe drejtësinë, heshtin prindërit

# Prindërit e Skerdilajd Konomit të kërcënuar, ruhen me policë

### Lajmi

**Prindërit e Skerdilajd Konomit, gjyqtarit të vrarë në mënyrë mafioze në mes të qytetit të Vlorës, ndihen të kërcënuar, dhe për këtë, kanë kërkuar mbrojtjen nga forcat e policisë së qytetit të Vlorës.**

VLORË

VIOLA MURATI

Lajmin e konfirmon për "Shqiptarja.com" shefi i komisariatit të policisë së Vlorës Alfred Elezi, i cili pohon se që nga data 1 tetor, shumë ditë në fakt pas vrasjes së bujshme të gjyqtarit Konomi, kanë kërkuar mbrojtjen nga forcat e rendit.

**NË SHTËPINË E SKERDILAJDIT**

Dje në shtëpinë e Skerdilajdit, bashkëshortja e tij, nuk pranoi t'i përgjigjej pyetjeve të gazetarëve lidhur me letrën tjetër që i kanë dërguar mediave dhe organeve kompetente për vrasjen e gjyqtarit të Vlorës. Ndërsa prindërit e Skerdilajdit, banojnë në një shtëpi me vete, jo me nusen e djalit. Në hyrje të shtëpisë së tyre, gjenden dy policë që nuk lejojnë askënd të futet brenda familjes. Familja është vendosur në mbrojtje në 1 tetor. "Vendosja e rojeve në shtëpinë e prindërve të gjyqtarit Skerdilajd Konomi është një prej çështjeve kryesore të planit të masave me numër 166 të datës 1 tetor 2011 për të garantuar dhe mbrojtur sigurinë fizike të familjarëve. Kjo masë është bërë me kërkesë të familjarëve për shkak të frikës së tronditjes që ata kanë kaluar. Masa është marrë që prej datës 1 tetor 2011 në një kohë të palimituar. Ndërkohë që task force e Prokurorisë është duke vazhduar hetimet për këtë çështje. Por nuk ka ende një kërkesë nga ana e saj" konfirmon për "Shqiptarja.com" shefi i komisariatit të qytetit të Vlorës Alfred Elezi. Nuk dihet nëse do të ketë një urdhër të dytë për të hequr mbrojtjen nga familja, nëna dhe babai i Skerdilajd Konomit, por deri tani gjithçka ka mbetur në gjendjen e 1 tetorit.



> Në hipotekën e Durrësit zyrtarët të thonë se prona e familjes Konomi nuk mund të kthehet edhe pse ka një vendim të gjykatës së Lartë

**LETRA PËR NDIHMË**

Dy ditë më parë familjarët e Skerdilajd Konomit nëpërmjet një letre drejtuar medias kanë kërkuar që shteti të japë drejtësi për Skerdilajdin, i cili u vra në mënyrë mafioze në mes të qytetit të Vlorës, në sytë e të gjithë njerëzve. Pista kryesore për të cilën po punohet dhe po hetohet nga organet e drejtësisë ka të bëjë me pronat, duke qenë se Konomi ka shumë prona në zonën e Durrësit në Hamallaj. Por ndërkohë në familjen e Skerdilajd Konomit, ka një shqetësim tjetër: Përveçse nuk po jepet drejtësi për djalin që u ekzekutua në mënyrë publike, institucionet e shtetit, Hipoteka e Durrësit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nuk po zbatojnë një vendim të gjykatës së lartë, që i kthen pronat familjes Konomi. Sipas tyre, çështja po zvarritet dhe askush nuk ka idenë se pse po ndodh një gjë e tillë. Në hipotekën e Durrësit zyrtarët të thonë se prona e familjes Konomi nuk mund të kthehet edhe pse ka një vendim të gjykatës së Lartë. Kjo sepse ka disa mbivendosje për çështje të pronësisë dhe organet kompetente të shtetit nuk mund të kthejnë pronën tek familja. Në fakt edhe në hetimet e prokurorisë kjo është një nga çështjet kryesore për të zbardhur vrasjen tragjike të gjyqtarit Konomi gjatë muajit shtator.

Grupi i prokurorëve që po heton intesivisht ekzekutimin e bujshëm me tritol të 33 vjeçarit Skerdilajd Konomi, pas dëshmive të shumta të marra nga familjarët dhe miqtë e tij, ka zbuluar disa detaje të rëndësishme në anë të të cilave shpresohet të shkohet drejt autorëve.

### VRASJA E GJYQTARIT

## Dëshmitë: Pati ofertë përpara ekzekutimit

**Sipas dëshmive të mbledhura nga prokuroria, në periudhën përpara ekzekutimit gjyqtari që kishte marë përsipër rikthimin e një prone me vlerë të jashtëzakonshme familjes, ka qënë i shqetësuar. Dhe kjo për faktin se disa "sekserë" i kishin kërkuar që të bëhej pjesë e një plani gjigand investimi në Gjirin e Lalzit, ku sipërfaqja prej 275 hektarësh që ishte dhe është ende në proces gjyqësor, ka një rëndësi të veçantë. Mësohet se Konomit, i është ofruar një shumë prej 10 milion eurosh nëse hiqte dorë nga vazhdimi i gjyqit të paktën për një pjesë të kësaj toke, 58 hektarë, e cila faktikisht vlen, edhe sipas me çmimeve më të ulta të tregut, të paktën 5 fish më shumë. Sipas dëshmive, Konomi ka preferuar që të vazhdojë betejën ligjore, të cilën mendonte se e kishte të fituar pas zbulimit të fallsifikimeve në regjistrin e pronave të vitit 1042, në Arkivin Qëndror të Shtetit.**

### Zyrtarët e Metrologjisë

# "Pendohet" Musabelliu, gati lirimi i Çelmetës

TIRANE

Sot në Gjykatë e Apeli, Tiranë, prokurorët që po hetojnë dosjen e 8 zyrtarëve të Metrologjisë të prangosur 8 ditë më parë për korrupsion, shkojnë për të mbrojtur masën e tyre "burg pa afat". Ndërkohë sipas burimeve pritet zbutja e masës me "arrest në shtëpi, për Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm Roland Çelmeta. Kreu i Drejtorisë së Metrologjisë dhe Kalibrimit për degën Tiranë,

### Lajmi

**Hetuesit e Antikrimit Ekonomik dhe Financiar në drejtorinë e policisë Tiranë, duket se kanë "kopsitur" akuzat për disa nga 8 zyrtarët e lartë të Metrologjisë. Vetë drejtori për Tiranën Mojsi Musabelli, ka pranuar të bashkëpunojë.**

Mojsi Musabelliu, gjatë pyetjeve në ditët pas arrestimit, ka pranuar faktet e dokumentuara nga agjentët e antikrimit ekonomik, dhe madje edhe ka bashkëpunuar. Lajmi konfirmohet nga burime Brenda Sektorit Kundër Krimit Finaciar e Ekonomik në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Mojsi Musabelliu, ndryshe nga 7 zyrtarët e tjerë të arrestuar, vetëm pas disa seancash pyetje, është dorëzuar përpara hetuesve. Mësohet gjithashtu se ai ka pranuar si të vërtetë rrëfimin e dy subjekteve, karburante praën liqenit artificial në Tiranë dhe një tjetër në qytetin e Elbasanit. Gjithashtu Mojsiu nuk ka mohuar "orgjinalitetin" e disa mandat pagesave dhe pullave të përdorura nga personat e pautorizuar. Por ai ka mohuhar se kjo veprimtari ka qenë e organizuar dhe në përmasa të mëdha. Sipas Musabelliut, rastet janë të pakta dhe sporadike. Ndërkohë ai ka pranuar se ka bashkëpunuar me inspektorin Kristaq Thanasi, i cili gjatë përgjimeve del si protagonist kryesor i gjithë veprimtarisë së hetuar. Sot avokatët e 8 zyrtarëve të arrestuar, do të kërkojnë nga gjykata e Apelit të Tiranës, lirimin e klientëve të tyre. Sipas tyre akuza ndaj tyre për shpërdorim detyre, është e pabazuar. Gjithsesi prokuroria beson se shumica e tyre do të ngelen në qeli deri në përfundim të hetimit dhe vendimit përfundimtar të Gjykatës së Faktit. Pas dëshmisë së të "penduarit" Musabelliu, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë dhe Kalibrimit, mund të kthehet sot në banesën e tij.

## Vrau hidraulikun, burg pa afat për 65 vjeçarin

Gjykata e Durrësit ka dhënë masën burg pa afat për për 65 vjeçarin Andera Berberi , i cili pak ditë më parë ekzekutoi me armë zjarri 40 vjeçarin Bujar Puja në qytetin e Durrësit. Në seancën e sotme të masës së sigurisë bëhet e ditur se Berberi ka pranuar krimin duke treguar para trupit gjykues dhe detajet se si ndodhi ngjarja. Vrasja është shkaktuar katër ditë më parë në banesën e autorit ku 40 vjeçari Luan Paja u ekzekutua me armë zjarri nga 65 vjeçari pas një sherri të nisur muaj më parë. Mesa duket mardhëniet mes hidraulikut dhe pronarit të shtëpisë ishin prishur për cilësinë e disa punimeve si dhe për pagësën e pa marrë nga ana e këtij të fundit. Vrasja është kryer në orët e para të mëngjesit, katër ditë më parë, pikërisht në çastin kur hidrauliku Bujar Puja ka kërkuar shpërblimin e punës që kishte bërë në shtëpinë e 65 vjeçarit Andrea Berberin. Fillimisht viktima ka shkuar në shtëpinë e tij duke kërkuar paratë me qetësi , por autori i është kthyr se asnjë punim që ai kishte kryer nuk është në cilësinë e duhur kështu që s'kishte ndërmend për ta paguar. Debati mes tyre ka vazhduar me konfrontime e më pas ka përfunduar tragjikisht.

### Edi Lika është futur në kryqëzim me të kuqe

# Zbardhet vendimi i gjykatës: Djali i Gramoz Ruçit i pafaj

### *Sipas ekspertit autoteknik Mark Gjonpalaj, shkak i aksidentit ka qenë mjetit tip MINI COOPER*



Edi Lika

**Lajmi**

**Zbardhet i plotë vendimi gjykatës për masën e lirimit të djalit të deputetit socialist Gramoz Ruçi. Sipas këtij vendimi shtetasi Edi Lika, ka qenë fajtor determinant, sepse sipaz ekspertizës, rezulton të ketë qenë me semafor të kuq.**

TIRANE

POLI HOXHA



Pavarësisht nga pretendimet e policisë, se ekspertiza nuk ka përfunduar akoma, prokurori që ndoqi çështjen e aksidentit të rëndë Blerim Tanushi, ka arritur në përfundim paraprak se fajtori i vetëm është drejtuesi i automjetit Mini Cooper Edi Lika. Në aksident ngeli e vdekur 26 vjeçarja Brunilda Pinderi.

**VENDIMI I PLOTË**

Tre ditë më parë në një seancë jo të zakonshme të zhvilluar në Spitalin Ushtarak, dy protogonistët e aksidentit Ledio Ruçi dhe Edi Lika, kamë dëgjuar fillimisht kërkesat e prokurorit të çështjes Blerim Tanushi, i cili i është referuar ekspertizës paraprake të autoteknikut Mark Gjonpalaj. Ai kërkoi "detyrim paraqitje" për djalin e deputetit socialist Gramoz Ruçi dhe "burg pa afat" për Edi Likën. Pas kësaj gjyqtari Fatri Islamaj, lexoi vendimin e masës, duke lënë në fuqi të dyja kërkesat e prokurorit.

"Më datës 20.11.2011 rreth orës 21.15 shtetasi Edi Lika ka qenë duke drejtuar mjetin tip MINI COOPER me targë CG 832 SC dhe është aksidentuar në vendin e quajtur 'Kryqëzimi i Rrugës së Elbasanit me Unazën', me mjetin tjetër tip BMË X6 me tarkë IKY 3939 të drejtuar nga shtetasi Ledio Ruçi. **Nga kjo përplasje rezulton se ka gjetur vdekjen shtetasja** Brunilda Pinderi, ndërsa të tjerët janë plagosur. Nga akti i ekspertimit paraprak i kryer nga eksperti autoteknik Mark Gjonpalaj, i njësisë së Policisë Rrugore Tiranës, ka rezultuar se shkak determinant për ardhjen e pasojës ka qenë shkelja e rregullave drejtuese të mjetit tip MINI COOPER me targë CG 832 SC, i cili, sipas prokurorit dhe aktit të ekspertimit rezulton të jetë futur në kryqëzim me semafor të kuq duke e shkelur kështu nenin 41 pika 2 dhe 10 të Kodit Rrugor. **Personi i marrë nën hetim, gjatë seancës gjyqësore nuk** pranoi këtë fakt dhe deklaroi se është futur në kryqëzim me semafor jeshil dhe jo të kuq", thuhet në vendimin e plotë të gjyqtarit Fatri Islamaj.

**REAGIMI**

Por ky vendim duket se nuk është kaluar qetë nga krerët e qarkullimit rrugor të kryeqytetit. Në një prononcim për "shqiptarja.com", shefi i hetimit të aksidenteve Ahmet Meshi, jo pa nerv tha " Hetimi dhe ekspertimi për ngjarjen vazhdon dhe sipas të dhënave të para të dy autorët e aksidentit mund të jenë fajtor, prandaj edhe kryem arrestimin e tyre në flagrancë. Nëse prokuroria mendon dhe ka gjetur autorin e vërtetë, ajo është punë e tyre. Pyesni ata. Ne do vazhdojmë punën tonë deri në përfundim të hetimit dhe ekspertizës". Ndërkohë dy ditë më parë janë zbardhur edhe filmimet e një kamere të vendodur në ambientet e një biznesi për shkëmbi valutash, sipas të cilave, pavarësisht se automjeti që drejtonte Ledio Ruçi, ka qenë me shpejtësi të madhe, ai ka kaluar semaforin me dritë jeshile, kurse e kundërta rezulton për automjetin e drejtuar nga Edi Lika. Nga ana tjetër prokurori i çështjes Blerim Tanushi, i vënë në dijeni nga "shqiptarja.com", për pretendimet e policisë i qetë ka deklaruar, se nuk është bërë asnjë shkelje në kërkesën e tij për lirimin me detyrim paraqitje të Ledian Ruçit. **"Nuk e di çfarë pretendime ka policia, por unë në bazë të** dëshmive dhe ekspertizës paraprake, arrita në përfundimin se shtetasi Eduard Cani, në momentin e aksidentit, ka qënë me shpejtësi të madhe dhe ka kaluar në momentin që semafori ka qënë me ngjyrën e kuqe. Gjithsesi hetimet vazhdojnë dhe lirimi i Ruçit nuk do të thotë se është përfundimtar"

### Adrian Nuçellari

# Kapet pas 11 vitesh, shtypi për vdekje tre italiane

TIRANE



Adrian Nuçellari

Një aksident i ndodhur në vitin 2000 në qytetin e Piza në Itali i ka kushtuar një 45 vjeçari shqiptar 20 vite burg, pasi aksidentoi për vdekje tre femra Italiane. Ardian Nurçellari është arrestuar ditën e djeshme në afërsi të kthesës së Kamzës, në bazë të kërkesës që ka bërë policia Italiane lidhur me aksidentin me pasojë vdekje të karabinierit. Gjatë vitit 2000 Ardian Nurçellari dyshohet se ishte i përfshirë në një rrjet kriminal lidhur me shfrytëzimin dhe prostitucionin e femrave. Në 5 shkurt të vitit 2000 Ardiani së bashku me grupin e tij kanë shkuar në një lokal nate në Piza dhe janë konfortuar me një grup shqiptarësh Lezhjanë.

Konfliktet mes tyre kanë lindur fillimisht për një femër ruse. Ardiani i mbylli debatet në lokal dhe e lanë të takoheshin të nesërmen për tu sqaruar. Grupi rival mes tyre dhe një person me emrin Admir ka qëlluar me grushte gjatë bisedave Ardianin ndërsa ky i fundit i ka ndjekur me makina për ta përplasur dhe ta aksidentonte. Por garat nëpër rruga favorizuan grupin Lezhian me nën krye Admirin, të cilët kanë parakaluar. Në këtë kohë Ardian Nurçellari ka përplasur për vdekje tre femra Italiane. Ai akuzohet për vrasjen me dashje të Sonia Cei 39 vjeçe, Sabrina Franchi 31 vjeçe dhe infermieres Susy Betti 37 vjece në një aksident rrugor të ndodhur në vitin 2000 në Viareggio, veri të Italisë.

Panvarsisht se Ardian Nurçellari, (Ostrovica) kërkonte të përplaste me xhipin e tij Pajero, një Peugeot 205 ku udhëtonte një tjetër shqiptar, por gjatë ndjekjes makina është përplasur me Citroenin e tre vajzave, duke shkaktuar vdekjen e tyre. Autori ishte dënuar nga gjykata Italiane me 20 vite heqie lirie, nga të cilat autori kishte kryer vetëm 15 vjet.

Pas arratisjes nga burgu Ardian Nuçellait i kishin mbetur dhe 5 vjet dhe 6 muaj burg. Ardiani ishte kthyer në Shqipëri në 27.5.2011 dhe ka udhëtuar nga Brukseli, ndërsa banonte në Unazën e re, në një banesë private, vile tre katëshe. I shoqëruar nga dy nënkomisarë ai është futur në anën e pasme të makinës së policisë dhe ka kërkuar më pas për të kryer një telefonatë. Ai ka marrë të fejuarën e tij duke i thënë: "Vonohem 2-3 orë, për gjithçka, fol me të shtëpisë time."

## Publikohet lista për Tiranën dhe të gjitha rrethet e tjera të vendit

# Policia: Ja kandidatet femra që do konkurrojnë për police

## *Kandidatet për police femra, zbardhen datat për konkurrim*



Ka përfunduar faza e aplikimit për kandidatet femra të interesuara për të ndjekur studimet në shkollën bazë të Policisë për Patrullë të Përgjithshme, dhe në gjithë vendin aplikuan 1651 femra. Të gjitha këto vajza do ti nënshtrohen testimit me shkrim në ambientet e Qendrës së Formimit Policor, në datat 10, 11 dhe 12 dhjetor. Në datën 10 dhjetor do të zhvillohet testimi me shkrim i kandidatëve të qarkut Tiranë, ndërkohë që në datën 11 dhjetor do të zhvillohet testimi me shkrim i kandidatëve nga qarqet Tiranë, me kodin e aplikimit nga 0001-0275 (pjesa e parë). Në orën 11.00' do të paraqiten për t'iu nënshtruar testimit me shkrim aplikantet e qarkut Tiranë me kodin e aplikimit nga 0276-0550 (pjesa e dytë). Në datën 11 dhjetor zhvillohet testimi me shkrim i kandidateve nga Qarqet Tiranë, Durrës, Dibër, Fier, Vlorë (pjesa e parë) dhe Berat. Në orën 07.00' paraqiten aplikantet e qarkut Tiranë me kodin e aplikimit nga 0551-0638 dhe kodin 1650-1651 (pjesa e tretë), kandidatet e qarkut Fier me kodin e aplikimit 0807-0825 (pjesa e parë) dhe gjithë aplikueset e Qarqeve Durrës dhe Dibër. Në orën 11.00 do të paraqiten për t'iu nënshtruar testimit me shkrim kandidatet e qarkut Fier (pjesa e dytë) me kodin e aplikimit 0826-0966, kandidatet e qarkut Vlorë (pjesa e parë) me kodin e aplikimit 1037-1100 dhe gjithë aplikueset e qarkut Berat. Më datë 12 dhjetor 2011, do të zhvillohet testimi me shkrim i kandidateve nga Qarqet Vlorë (pjesa e dytë), Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Lezhë dhe Shkodër. Në orën 07.00' do të paraqiten për t'iu nënshtruar testimit me shkrim kandidatet e qarkut Vlorë (pjesa e dytë) me kodin e aplikimit 1101-1121, kandidatet e qarkut Kukës (pjesa e parë) me kodin e aplikimit 1331-1375 dhe gjithë aplikantet e qarqeve Gjiirokastër, Shkodër e Lezhë. Në orën 11.00' do të paraqiten për t'iu nënshtruar testimit me shkrim kandidatet e qarkut Kukës (pjesa e dytë) me kodin e aplikimit 1376-1418, si dhe gjithë aplikantet e qarqeve Elbasan dhe Korçë.

| Nr. | Emër, Atësi, Mbiemër | Qarku | Kodi |
|---|---|---|---|
| 1 | Erjona Xhevit Ramaj | Tiranë | 0001 |
| 2 | Alentine Vasil Kola | Tiranë | 0002 |
| 3 | Evelina Kroni Rina | Tiranë | 0003 |
| 4 | Sontila Isuf Kurbala | Tiranë | 0004 |
| 5 | Aurora Albert Oskian | Tiranë | 0005 |
| 6 | Ana Soklol Shiqerukaj | Tiranë | 0006 |
| 7 | Brunilda Pavllo Çoliu | Tiranë | 0007 |
| 8 | Arminda Resmi Tafalla | Tiranë | 0008 |
| 9 | Mirjeta Xhemajl Pepnikaj | Tiranë | 0009 |
| 10 | Ermira Ndue Gacaj | Tiranë | 0010 |
| 11 | Gjyslina Kapllan Guri | Tiranë | 0011 |
| 12 | Elona Kapllan Mollanji | Tiranë | 0012 |
| 13 | Evangjelia Gjergji Thimo | Tiranë | 0013 |
| 14 | Silvana Prend Bibaj | Tiranë | 0014 |
| 15 | Diamela Murat Prenga | Tiranë | 0015 |
| 16 | Fjoralba Muharrem Alla | Tiranë | 0016 |
| 17 | Katrina Zef Palushaj | Tiranë | 0017 |
| 18 | Arjana Abaz Sula | Tiranë | 0018 |
| 19 | Anile Petrit Gjini | Tiranë | 0019 |
| 20 | Entela Hajrulla Sokoli | Tiranë | 0020 |
| 21 | Lidia Ilir Banushi | Tiranë | 0021 |
| 22 | Engjellushe Gafurr Visha | Tiranë | 0022 |
| 23 | Shqiponja Kukel Qokaj | Tiranë | 0023 |
| 24 | Sueda Uzri Hamzai | Tiranë | 0024 |
| 25 | Lorenca Edmond Zefi | Tiranë | 0025 |
| 26 | Alketa Sylejman Neziraj | Tiranë | 0026 |
| 27 | Deljana Seid Xhameta | Tiranë | 0027 |
| 28 | Ina Refat Zylyftari | Tiranë | 0028 |
| 29 | Ana Refat Zylyftari | Tiranë | 0029 |
| 30 | Alketa Zenel Mulgeci | Tiranë | 0030 |
| 31 | Romina Bardhi Selmani | Tiranë | 0031 |
| 32 | Silvana Rasim Kopani | Tiranë | 0032 |
| 33 | Matilda Xhemal Hysenleka | Tiranë | 0033 |
| 34 | Morena Xhemal Hysenleka | Tiranë | 0034 |
| 35 | Erjola Fran Lika | Tiranë | 0035 |
| 36 | Donika Naim Sherifi | Tiranë | 0036 |
| 37 | Mirela Sulejman Rama | Tiranë | 0037 |
| 38 | Eranda Adriatik Beqo | Tiranë | 0038 |
| 39 | Borana Naim Hyska | Tiranë | 0039 |
| 40 | Irna Irfan Toska | Tiranë | 0040 |
| 41 | Jonida Xhevair Kanani | Tiranë | 0041 |
| 42 | Suela Gani Bega | Tiranë | 0042 |
| 43 | Ornela Qamil Palaniku | Tiranë | 0043 |
| 44 | Bekime Nuredin Rexha | Tiranë | 0044 |
| 45 | Dorjana Qerim Kolgjini | Tiranë | 0045 |
| 46 | Anila Ilmi Gjergji | Tiranë | 0046 |
| 47 | Drisona Sefer Hysa | Tiranë | 0047 |
| 48 | Manuela Agron Satka | Tiranë | 0048 |
| 49 | Ermira Qani Jançes | Tiranë | 0049 |
| 50 | Klaudja Barjam Çepa | Tiranë | 0050 |
| 51 | Anila Osman Mamoçi | Tiranë | 0051 |
| 52 | Florentina Sinan Domi | Tiranë | 0052 |
| 53 | Luljeta Hysen Leskaj | Tiranë | 0053 |
| 54 | Elvanda Arben Buçpapaj | Tiranë | 0054 |
| 55 | Sabrina Muhamet Qypi | Tiranë | 0055 |
| 56 | Mimoza Rexhep Zisko | Tiranë | 0056 |
| 57 | Vjollca Frang Mjekaj | Tiranë | 0057 |
| 58 | Lule Frrok Gega | Tiranë | 0058 |
| 59 | Kimete Selman Salihi | Tiranë | 0059 |
| 60 | Larisa Sami Sallaku | Tiranë | 0060 |
| 61 | Ariola Naim Losha | Tiranë | 0061 |
| 62 | Xhevriko Adriatik Mançe | Tiranë | 0062 |
| 63 | Valmira Sadik Logu | Tiranë | 0063 |
| 64 | Aleksandra Emin Hunçi | Tiranë | 0064 |
| 65 | Rahime Emin Hunçi | Tiranë | 0065 |
| 66 | Leoreta Pjeter Ndoj | Tiranë | 0066 |
| 67 | Lindita Gjon Gjoni | Tiranë | 0067 |
| 68 | Nerta Hasim Brimi | Tiranë | 0068 |
| 69 | Florida Sule Vatoci | Tiranë | 0069 |
| 70 | Fatmira Sokol Demaj | Tiranë | 0070 |
| 71 | Dhurata Hysen Kulla | Tiranë | 0071 |
| 72 | Etleva Haxhi Qoku | Tiranë | 0072 |
| 73 | Besa Misim Hysenaj | Tiranë | 0073 |
| 74 | Matilda Faik Cani | Tiranë | 0074 |
| 75 | Elda Dilaver Tota | Tiranë | 0075 |
| 76 | Pajtesa Idris Bisha | Tiranë | 0076 |
| 77 | Rudesa Heqerem Vaja | Tiranë | 0077 |
| 78 | Nertila Skender Hoxha | Tiranë | 0078 |
| 79 | Sabihate Vesel Mici | Tiranë | 0079 |
| 80 | Blerina Islam Lloçi | Tiranë | 0080 |
| 81 | Aurora Agron Ustaj | Tiranë | 0081 |
| 82 | Valbona Ali Doçaj | Tiranë | 0082 |
| 83 | Albana Ndoc Geci | Tiranë | 0083 |
| 84 | Florinda Ivzi Mata | Tiranë | 0084 |
| 85 | Klodjana Abaz Berberi | Tiranë | 0085 |
| 86 | Ludjana Mustehak Rrapa | Tiranë | 0086 |
| 87 | Adelajda Ramadan Gorica | Tiranë | 0087 |
| 88 | Filomena Agron Xhelezi | Tiranë | 0088 |
| 89 | Manuela Nase Krasnika | Tiranë | 0089 |
| 90 | Rezarta Nexhmi Ramollari | Tiranë | 0090 |
| 91 | Ogerta Lutfi Duriçi | Tiranë | 0091 |
| 92 | Drilona Adrian Ahmeti | Tiranë | 0092 |
| 93 | Vilma Demir Ago | Tiranë | 0093 |
| 94 | Irsida Astrit Polena | Tiranë | 0094 |
| 95 | Marsela Kapo Myrtaj | Tiranë | 0095 |
| 96 | Anisa Arben Murraku | Tiranë | 0096 |
| 97 | Mirlanda Kujtim Arapaj | Tiranë | 0097 |
| 98 | Ornida Astrit Dervishi | Tiranë | 0098 |
| 99 | Elona Beqir Xhaku | Tiranë | 0099 |
| 100 | Marsilda Qemal Hysa | Tiranë | 0100 |
| 101 | Entela Enver Nexhi | Tiranë | 0101 |
| 102 | Jonida Besim Bozhiqi | Tiranë | 0102 |
| 103 | Erida Bedri Muho | Tiranë | 0103 |
| 104 | Edlira Edmont Gremi | Tiranë | 0104 |
| 105 | Jerina Agim Hoxha | Tiranë | 0105 |
| 106 | Jenora Agim Hoxha | Tiranë | 0106 |
| 107 | Nora Vate Qokaj | Tiranë | 0107 |
| 108 | Leonora Kujtim Ndreu | Tiranë | 0108 |
| 109 | Blerta Miço Llupo | Tiranë | 0109 |
| 110 | Dorina Muarem Molla | Tiranë | 0110 |
| 111 | Drilona Pjeter Gjonai | Tiranë | 0111 |
| 112 | Dorina Shefqet Cani | Tiranë | 0112 |
| 113 | Migene Bajram Brucaj | Tiranë | 0113 |
| 114 | Liridona Bajram Dreni | Tiranë | 0114 |
| 115 | Semiramida Ajaz Kacdedia | Tiranë | 0115 |
| 116 | Brunilda Hysen Ismailaj | Tiranë | 0116 |
| 117 | Suela Enver Varrosi | Tiranë | 0117 |
| 118 | Entela Hysen Mustafaj | Tiranë | 0118 |
| 119 | Manjola Mehmet Doka | Tiranë | 0119 |
| 120 | Gentila Rreme Hajdaraj | Tiranë | 0120 |
| 121 | Silva Sabri Xhani | Tiranë | 0121 |
| 122 | Kezjana Shkelqim Lile | Tiranë | 0122 |
| 123 | Marsida Çelë Hasmujaj | Tiranë | 0123 |
| 124 | Arsida Naim Emrullaj | Tiranë | 0124 |
| 125 | Anduena Imer Çangu | Tiranë | 0125 |
| 126 | Sonila Sotir Banushi | Tiranë | 0126 |
| 127 | Vilda Petrit Mata | Tiranë | 0127 |
| 128 | Leze Frrok Gega | Tiranë | 0128 |
| 129 | Valbona Sherif Bega | Tiranë | 0129 |
| 130 | Drilona Qazim Kucaj | Tiranë | 0130 |
| 131 | Gentjana Muharrem Haxhiu | Tiranë | 0131 |
| 132 | Ornela Naim Isufi | Tiranë | 0132 |
| 133 | Lirije Liman Ismahili | Tiranë | 0133 |
| 134 | Blerina Tefik Muçi | Tiranë | 0134 |
| 135 | Arta Hasan GJika | Tiranë | 0135 |
| 136 | Dorinela Zef Gjoka | Tiranë | 0136 |
| 137 | Esmerilda Avdi Begati | Tiranë | 0137 |
| 138 | Alketa Mal Agaj | Tiranë | 0138 |
| 139 | Denada Zija Kapaj | Tiranë | 0139 |
| 140 | Holta Bashkim Selmanllari | Tiranë | 0140 |
| 141 | Sidorela Hasan Ahmetaj | Tiranë | 0141 |
| 142 | Jorida Novrus Ibrahimi | Tiranë | 0142 |
| 143 | Anida Ymer Çaushi | Tiranë | 0143 |
| 144 | Adela Petrit Belba | Tiranë | 0144 |
| 145 | Eranda Fitim Zaimi | Tiranë | 0145 |
| 146 | Mamica Sotir Tasho | Tiranë | 0146 |
| 147 | Dorina Petrit Shkoza | Tiranë | 0147 |
| 148 | Agetina Prend Perzefi | Tiranë | 0148 |
| 149 | Merushe Fatmir Kinçe | Tiranë | 0149 |
| 150 | Denada Mestan Zylali | Tiranë | 0150 |
| 151 | Manuela Laver Pere | Tiranë | 0151 |
| 152 | Doruntina Jak Lleshaj | Tiranë | 0152 |
| 153 | Orkida Vesel Hoxha | Tiranë | 0153 |
| 154 | Marsela Bilal Çela | Tiranë | 0154 |
| 155 | Loreta Hetem Laho | Tiranë | 0155 |
| 156 | Mirjeta Nezir Dervishi | Tiranë | 0156 |
| 157 | Nertila Xhavit Çaça | Tiranë | 0157 |
| 158 | Merita Shefki Hasi | Tiranë | 0158 |
| 159 | Brunilda Dashamir Cufaj | Tiranë | 0159 |
| 160 | Xhovalina Shajin Toska | Tiranë | 0160 |
| 161 | Meriljana Bilal Hysa | Tiranë | 0161 |
| 162 | Anjeza Haki Sefa | Tiranë | 0162 |
| 163 | Dorina Shahin Musaj | Tiranë | 0163 |
| 164 | Ilirjeta Xhevat Qyra | Tiranë | 0164 |
| 165 | Mide Avni Meçi | Tiranë | 0165 |
| 166 | Entela Ajet Zhula | Tiranë | 0166 |
| 167 | Jetmira Sulejman Dervishi | Tiranë | 0167 |
| 168 | Luljeta Fadil Metoshi | Tiranë | 0168 |
| 169 | Mbarime Zyber Lika | Tiranë | 0169 |
| 170 | Lejdia Leonidha Mano | Tiranë | 0170 |
| 171 | Elsa Xhezmir Hova | Tiranë | 0171 |
| 172 | Rudina Sadri Gaga | Tiranë | 0172 |
| 173 | Silvana Ivzi Hajdari | Tiranë | 0173 |
| 174 | Junila Besim Kolgjini | Tiranë | 0174 |
| 175 | Esmiralda Ismet Toskaj | Tiranë | 0175 |
| 176 | Zana Tare Kalemi | Tiranë | 0176 |
| 177 | Selina Kujtim Tahja | Tiranë | 0177 |
| 178 | Rezarta Gezim Matoshi | Tiranë | 0178 |
| 179 | Armida Bedri Shukulli | Tiranë | 0179 |
| 180 | Katrine Lulash Pjetri | Tiranë | 0180 |
| 181 | Brikena Gjovalin Gjeta | Tiranë | 0181 |
| 182 | Eneda Zoj Veliu | Tiranë | 0182 |
| 183 | Resmie Xhemal Mera | Tiranë | 0183 |
| 184 | Albana Xhavit Alistafa | Tiranë | 0184 |
| 185 | Irta Petrit Kerçuku | Tiranë | 0185 |
| 186 | Lirije Sabri Elezi | Tiranë | 0186 |
| 187 | Gentiana Bajram Katoçi | Tiranë | 0187 |
| 188 | Desara Haki Bytyçi | Tiranë | 0188 |
| 189 | Age Nikolin Ndon | Tiranë | 0189 |
| 190 | Alma Rexhep Demaj | Tiranë | 0190 |
| 191 | Borjana Sulejman Biba | Tiranë | 0191 |
| 192 | Juljana Xhevair Perona | Tiranë | 0192 |
| 193 | Liljana Haziz Rreshka | Tiranë | 0193 |
| 194 | Roksela Perlat Bello | Tiranë | 0194 |
| 195 | Lirije Ismail Gjoshi | Tiranë | 0195 |
| 196 | Eranda Metat Ahmeti | Tiranë | 0196 |
| 197 | Manjola Asllan Shaqa | Tiranë | 0197 |
| 198 | Natasha Sulejman Gjyla | Tiranë | 0198 |
| 199 | Fatjona Nazmi Berexha | Tiranë | 0199 |
| 200 | Orjalda Sali Bajraktari | Tiranë | 0200 |
| 201 | Frida Ymer Qose | Tiranë | 0201 |
| 202 | Blerina Sali Zelaj | Tiranë | 0202 |
| 203 | Jonida Idajet Shima | Tiranë | 0203 |
| 204 | Sofie Xhevair Hasa | Tiranë | 0204 |
| 205 | Violeta Zenel Uka | Tiranë | 0205 |
| 206 | Alma Anton Gega | Tiranë | 0206 |
| 207 | Klara Shkelqim Isallari | Tiranë | 0207 |
| 208 | Alvorina Petrit Poka | Tiranë | 0208 |
| 209 | Daniela Vladimir Dajlani | Tiranë | 0209 |
| 210 | Elidjana Xhevahir Toçila | Tiranë | 0210 |
| 211 | Elisa Zog Hysenaj | Tiranë | 0211 |
| 212 | Egra Astrit Ibrahimi | Tiranë | 0212 |
| 213 | Irena Mark Kola | Tiranë | 0213 |
| 214 | Jurgena Bajram Bajrami | Tiranë | 0214 |
| 215 | Laureta Nikoll Nili | Tiranë | 0215 |
| 216 | Elda Ali Çelaj | Tiranë | 0216 |
| 217 | Xhuljeta Gjon Shpani | Tiranë | 0217 |
| 218 | Anisa Sami Hadri | Tiranë | 0218 |
| 219 | Resmije Sami Hajdari | Tiranë | 0219 |
| 220 | Xhensila Fatmir Gjondedaj | Tiranë | 0220 |
| 221 | Julian Sali Zelaj | Tiranë | 0221 |
| 222 | Aferdita Abaz Sula | Tiranë | 0222 |
| 223 | Frozina Gjergj Prenga | Tiranë | 0223 |
| 224 | Rada Fatos Alimani | Tiranë | 0224 |
| 225 | Malvina Selami Prrenjasi | Tiranë | 0225 |
| 226 | Erjola Rexhep Keçi | Tiranë | 0226 |
| 227 | Manushaqe Shaban Pana | Tiranë | 0227 |
| 1075 | Zamira Vendigjar Agalliu | Vlorë | 1075 |
| 1076 | Matilda Festim Muçaj | Vlorë | 1076 |
| 1077 | Izabela Jaho Jahaj | Vlorë | 1077 |
| 1078 | Irena Ferman Velaj | Vlorë | 1078 |
| 1079 | Vjollca Ferman Velaj | Vlorë | 1079 |
| 1080 | Erigerta Nikolla Gjata | Vlorë | 1080 |
| 1081 | Adelina Vlashi Vokrri | Vlorë | 1081 |
| 1082 | Briseida Nikollaq Mone | Vlorë | 1082 |
| 1083 | Ermira Rasim Bejtaj | Vlorë | 1083 |
| 1084 | Mansoljana Fatmir Bendaj | Vlorë | 1084 |
| 1085 | Edlira Novruz Shabani | Vlorë | 1085 |
| 1086 | Erjola Bujar Mimini | Vlorë | 1086 |
| 1087 | Einas Sali Saliu | Vlorë | 1087 |
| 1088 | Behare Shemo Hallkoj | Vlorë | 1088 |
| 1089 | Marinela Vangjel Koça | Vlorë | 1089 |
| 1090 | Natasha Shemo Ballaj | Vlorë | 1090 |
| 1091 | Esmeralda Servet Menaj | Vlorë | 1091 |
| 1092 | Shqiponja Myqerem Duraj | Vlorë | 1092 |
| 1093 | Klodjana Mufit Selmanaj | Vlorë | 1093 |
| 1094 | Marsela Festim Canaj | Vlorë | 1094 |
| 1095 | Esmeralda Lutfi Ago | Vlorë | 1095 |
| 1096 | Leli Agim Meçorrapaj | Vlorë | 1096 |

**Pjesën tjetër të emrave dhe listën e plotë do e lexoni në: www.shqiptarja.com**



**EKSPERTË TURKË PËR TRAMIN**

**Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, ka zhvilluar një vizitë në bashkinë e Ankarasë dhe të Stambollit, nga të cilët ka marrë mbështetje për projekte konkrete që do të ndihmojnë ecjen përpara të Tiranës. Një ndër tyre është edhe premtimi i dhënë nga drejtues të niveleve më të larta qeveritre, se ata janë të gatshëm të ndihmojnë Tiranën, në ndërtimin e sistemit të tramvajit, që do të shmangte trafikun e rënduar.**




**JURIDIKU, ENDE REGJISTRIME**

**Në fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës ende vazhdojnë regjistrimet e fituesve të masterave. Megjithëse sipas rregullores së Ministrisë së Arsimit, regjistrimet e fituesve duhet të ishin mbyllur që me datë 10 nëntor, ditën e martë, ky fakultet ka shpallur fazën e dytë të fituesve të masterave profesionalë. Ajo që vihet re është se në këtë listë të dytë, pjesa më e madhe e fituesve vinin nga universitetet private, ndërkohë që nuk mungonin as ata nga rrethet.**

### Përmirësohet shëndeti i politikanit, lë reanimacionin për një dhomë të veçantë

# Berisha viziton Godon në spital, aksion për pastrimin e oborrit

## Lajmi

**Kryeministri Sali Berisha ka vizituar dje në reanimacionin e Sanatoriumit, politikanin 82-vjeçar, Sabri Godo. Vizita e kreut të qeverisë është shoqëruar jo vetëm me masa të rrepta sigurie, por ka angazhuar edhe drejtorinë e spitalit që të pastrojë ambientet përreth nga mbeturinat e hedhura pa kujdes.**



## Sëmundja

Sabri Godo ka mbërritur të hënën në darkë në reanimacionin e Sanatorimit, pas një krize të fortë në mushkëri. Mjekët thanë se ai vuan nga një tumor në mushkëri, i cili i ka shkaktuar edhe likid pleural

TIRANE

ESMERALDA KETA

Është mesditë dhe kemi shkuar në Sanatorium për të mësuar diçka rreth gjendjes shëndetësore të politikanit dhe shkrimtarit të njohur, Sabri Godo.

**Bluzat e bardha të katit të tretë, ku edhe ndodhet reanimacioni**, janë të tensionura dhe askush nuk na kthen përgjigje, por nxitojnë të mbarojnë punët e tyre. Marrim vesh se nga momenti në moment pritet të vijë kryeministri Berisha, i cili sapo ka marrë vesh që gjendja shendetësore e Sabri Godos është përmirësuar disi, do t'i bëjë një vizitë kortezie.

**Tek dera kryesore e katit të parë janë tre të afërm** pacientësh, të cilët presin mjekun për të marrë vesh ndonjë gjë për familjarin e tyre. Në këtë kohë, mbërrin edhe shefi i personelit, i cili shkëmben batuta të tensionuara me rojen: Po këta çfarë duan këtu? Këtu do të rrinë?", - thotë ai dhe largohet pa pritur të marrë ndonjë përgjigje konkrete nga roja i spitalit.

**Është ora rreth 12:00 e mesditës. Truprojat** e Berishës kanë mbërritur dhe drejtuesit e spitalit janë si në gjemba. Menjëherë, kanë angazhuar edhe një skuadër me pastruese që heqin shpejt e shpejt, qese plastmasi, shishe plastike apo mbeturina ambalazhesh të tjera të hedhura pa kujdes në lulishten përpara hyrjes kryesore të spitalit Universitar të Mushkërive "Shefqet Ndroqi", të njohur si Sanatoriumi. Pas kësaj, duket sikur gjithçka është vënë në terezi dhe pritet vetëm mbërritja e kryeministrit Berisha, i cili po vonon. Ne marrim autobuzin e kthimit për në Tiranë, ndërkohë që afër kryqëzimit me Saukun, urbani shkëmbehet me eskortën e Berishës, i cili po shkon të vizitojë Godon. Dhe në këtë moment nuk mungojnë as batutat e personave që ndodhen në autobus që thonë "Berisha po shkon të shërojë Godon".

**Nga vizita e kryeministrit në spital, arrijmë të** mësojmë vetëm disa detaje të vogla. Ai nuk ka qëndruar gjatë me politikanin e njohur edhe për shkak të gjendjes së rënduar të tij. Por mësohet se ai i ka premtuar Godos, por edhe vajzës së tij mjeke, Anilës, se mjekët e Sanatoriumit do të bëjnë gjithçka për kurimin sa më të mirë të tij.

**SHËNDETI**

Në fakt gjatë mesnatës së të mërkurës shëndeti i Sabri Godos është përmirësuar disi, por megjithatë gjatë gjithë ditës së djeshme ai ka qëndruar në reanimacion. Por duket se gjendja e tij shëndetësore ka ardhur duke u përmirësuar, ndaj edhe të enjten në darkë, rreth orës 20:00, stafi i mjekëve që e mbikqyrin shëndetin e tij e kanë parë të arsyeshme që ai të lërë reanimacionin dhe të shtrohet në një dhomë të veçantë në pavijonin e kirurgjisë. Sigurisht edhe në këtë dhomë ai mbahet nën mbikqyrje të rreptë mjekësore.

**Mjekët, duke dashur të respektojnë kërkesën e vajzës** së poltikanit, Anila Godo, i janë përgjigjur interesimit të mediave me disa informacione të vakëta. Ai vuan nga një tumor në mushkëri, i cili i ka shkaktuar edhe likid pleural, ndërsa dy ditë më parë ai i është nënshtruar një ndërhyrjeje për heqjen e një mase tumorale.

SËMUNDJA

## Tumor në mushkëri, sëmundja që ka prekur Godon

**Politikani i njohur Sabri Godo vuan nga tumori në mushkëri. Sipas vajzës së tij, ish-ministres së Shëndetësisë, Anila Godo, gjatë ditës së hënë, ai i ka dhënë një goditje të papritur dhe shumë të fortë, si pasojë e të cilës ai ka përfunduar në reanimacion. Onkohematologia e njohur e pediatrisë së QSUT-së, ka shpjeguar se ai po merr kurën e nevojshme dhe familjarët nuk kanë ndërmend që ta lëvizin nga Sanatoriumi për të dërguar jashtë vendit. Pasi shëndeti i tij të përmirësohet disi, Godo do të kalojë në një dhomë më vete, pasi sallan e reanimacionit ai e ndan edhe me katër pacientë të tjerë.**

NISMA

## 16 ditë kundër dhunës së grave

**Do të jënë plot 16 ditë aktivitete sensibilizuese, kundër dhunës që ushtrohet ndaj grave dhe barazisë gjinore. Ministria e Punës në bashkëpunim me OBSH dhe shoqatën "Në dobi të gruas" do të çelin gjatë ditës së sotme këtë fushatë sensibilizimi, në lulishten e parkut Rinia. Nismëtarët e kësaj nisme deklarojnë se të gjithë këto aktivitete kanë si qëllim që të përcjellin një mesazh të madh kundër dhunës ndaj grave. Motoja "Dhuna është krim" si dhe një puzzle e madh prej 30 metrash katorë, i cili do të shërbejë, ku çdo kush prej qytetarëve të shënojë një mesazh ndaj këtij fenomeni, do të shërbejnë për ta sjellë dhunën ndaj grave dhe problemin e barazisë gjinore pranë të gjithë opinionit publik. Më pas këto pjesëza të puzzle do të ngjiten për të formuar një puzzel gjigand, me kuptimin që këto pjesëza të vogla, të pafuqishme, kur bashkohen mund të japin një mesazh të madh sensibilizimi kundër dhunës që ushtrohet çdo ditë ndaj grave. Kjo do të jetë vetëm çelja e aktiviteteve që do të zhvillohen në mbarë vendin ditën e parë, të dhunës kundër grave, ndërkohë që me qindra aktivitete do të mund të zhvillohen në 16 ditët e sensibilizimit, ndaj këtij fenomeni që ka prekur shumë familje shqiptare dhe po bëhet gjithmonë e më shqetësues.**

### Shëndeti mendor

# Vuajnë 25% e shqiptarëve

TIRANE

Një në 5 shqiptarë, vuan nga probleme të shëndetit mendor. Në një raport të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për Shqipërinë thuhet se sa i përket shifrave të personave që lënë psikiatrinë ata janë fiktive, pasi një pjesë e madhe i drejtojhen këtij shërbimi vetëm për të marrë fletën e KEMP-it. Ndërkohë që ish-shefi i Psikiatrisë në Qendrën Universitare Spitalore "Nënë Tereza", Anastas Suli, ka ngritur një tjetër shqetësim: atë që mjekët e parësorit nuk e njohin këtë sëmundje sa duhet, duke bërë që të mos kapin në kohë një pjesë të madhe të pacientëve që kanë probleme të shëndetit mendor. Ndaj ai i ka sugjeruar ministrisë hapjen e sa më shumë qendrave komunitare për identifikimin në kohë të personave me probleme mendore. Deklaratat janë bërë gjatë një takimi të organizuar nga ministria e Shëndetësisë dhe OBSH me rastin e përfundimit të projektit të saj të Shëndetit Mendor. Në këtë takim profesionistësh është prezantuar edhe projketligji i ri "Për Shëndetin Mendor" dhe draft plani për veprim dhe zhvillim të shërbimeve të shëndetit mendor në vendin tonë për periudhat 2011-2020. "Ne kemi hyrë në rrugën e pakthyeshme ku shërbimet e shëndetit mendor ofrohen nga ekipe multi-disiplinare, me qëllim trajtimin e pacientëve sa më pranë shtëpisë të jetë e mundur, në një rrjet shërbimesh komunitare dhe me shtretër të cilat funksionojnë në mënyrë të integruar dhe të vazhduar", - ka deklaruar ministri Vasili.

## Lajmi

**Mjekët e shërbimit parësor duhet të jenë më të vëmendshëm ndaj sëmundjeve të shëndetit mendor, pasi si pasojë e mosfunksionimit të kësaj strukture të sëmurët nuk kapen në kohë. Ish-shefi i Psikiatrisë, Anastas Suli, ka propozuar që të ngrihen sa më shumë qendra komunitare të shëndetit mendor.**

## Bashkia Kamëz, shemben 50 ndërtime të paligjshme

Bashkia e Kamzës ka prishur rreth 50 ndërtime pa leje. Sipas zyrës së shtypit të kësaj bashkie, aksioni që fillimisht ka nisur brenda kontureve të qytetit Kamëz, do të shtrihet në gjithë territorin e bashkisë. "Pas investigimeve të kryera në terren, konstatohet se deri tani janë prishur rreth 21 mure rrethuese dhe 32 objekte një dhe dykatëshe, kryesisht shtesa anësore rreth pallateve. Ndërhyrja konsiston në lirimin e të gjitha hapësirave publike të qytetit, siç janë shtesa pallatesh, ndërtime pa leje, baraka e garazhe të ndërtuara rreth e qark pallateve, gjatë periudhave të tranzicionit në 20 vitet e fundit", - ka sqaruar më tej zyra e shtypit e kësaj bashkie. Në hapësirat publike që do të lirohen pas këtyre prishjeve, do të bëhen zgjerime rrugësh, trotuare, hapësira të gjelbra, lulishte, stola për pushim dhe mbjellje pemësh, kënde lojërash për fëmijët, në mënyrë që qytetarët e Kamzës të marrin frymë më lirisht, të kenë ambiente sa më të këndshme për pushim, ku të kalojnë kohën e lirë. Aksioni është bërë nga drejtoria e planifikimit të territorit dhe inspektorati ndërtimor urbanistik.

### Ligji i ri: Kanë të drejtë të rikandidojnë

# Ribëhet ligji për Dhori Kulen, dështon sërish Shezai Rrokaj

## Profesorët kundër: Nuk mund të ndryshohet sa herë që dikush ka interesa personale




**Lajmi**

**Rektori aktual i Universitetit të Tiranës, Dhori Kule ka të drejtë të kandidojë sërish për këtë post, ndërsa dekani i Filologjikut duhet të kënaqet me pozicionin aktual. Kjo pasi ligji për mandatin e rektoritdhe dekanit ka ndryshuar sërish duke u dhënë të drejtën për dy mandate radhazi.**

TIRANE

ESMERALDA KETA

Propozimi për të ndryshuar ligjin për mandatin e rektorit dhe të dekanit është bërë nga vetë stafet akademike, ndërkohë që pritet që gjatë javës që vjen ky ndryshim të firmosët. Duke bërë që rektorët dhe dekanët të kenë të drejtën e dy mandateve radhazi, për të njëjtin pozicion. E thënë me fjalë më të thjeshta, ndryshimi i këtij ligji, u jep të drejtën rektorëve dhe dekanëve aktualë, të të gjithë universiteve publike, që të mund të rikandidojnë sërish për të njëjtin post, në zgjedhjet e reja të universiteve që priten të zhvillohen në muajin janar, ndërsa ai aktuali e ndalonte një person të kishte dy mandate të tilla radhazi.

**Në fakt ndryshimi i këtij ligji është bërë në mënyrë të** papritur dhe ka "prerë në besë" mjaft profesorë të tjerë, të cilët ishin bërë gati që të kandidonin në postin e rektorit apo të dekanit.

Ndryshimet nuk janë zyrtarizuar akoma, por pritet që ata të marrin firmën edhe të qeverisë gjatë javës që vjen dhe me ligjin e ri do të hapet edhe gara për zgjedhjet e reja në universitet.

**Vetë profesorët e shohin me dyshim faktin që** ligji është ndryshuar në momentet e fundit, vetëm pak javë përpara hapjes së procesit të zgjedhjeve. "Ndryshimi i ligjit për mandatin e rektorit dhe të dekanit vetëm pak javë përpara zgjedhjeve, nuk është një shenjë e mirë. Nuk mund të ndryshohen ligjet sa herë që dikush ka interesa personale dhe të drejpërdrejta, pasi ky ligj, u ndryshua në këtë formë që është tani, para katër vitesh. Tani që po u mbarojnë mandatet disave, kanë ndërhyrë që të ndryshojë sërish ligji dhe t'i japin kështu edhe një mandat tjetër vetes", - na thonë profesorët. Pritet që pas zyrtarizimit të ndryshimeve, ligji të shoqërohet edhe me debate të forta.

LIGJI

### Ndryshon dy herë brenda katër viteve

**Në vitin 2008 ligji përcaktonte që rektori dhe dekani mund të kishte dy mandate të njëpasnjëshme, nëse ai fitonte votat e kolegëve të tij. Po këtë vit, kur edhe u zhvilluan zgjedhjet, ligji ndryshoi, duke përcaktuar se një rektor a dekan mund ta mbante këtë post vetëm për një mandat, ndërsa kishte të drejtë të garonte për dekan kur më parë kishte qenë rektor dhe anasjelltas. Ndërkohë që katër vjet më pas, në prag të zgjdhjeve të reja të 2012-ës në universitete, ky ligj ndryshon sërish duke u dhënë të drejtën rektorëve dhe dekanëve të mbajnë dy mandate radhazi të njëjtin post. Sigurisht nëpërmjet garës.**

GARA

Gara më e fortë pritet të zhvillohet në universitetin e Tiranës. Nëse para katër vitesh ish-rektori i atëhershëm, Shezai Rrokaj, u detyrua të hiqte dorë nga gara për rektor. pasi ligji ndryshoi edhe asokohe pak para zgjedhjeve, dhe parashikonte që rektori apo dekani, nuk mund të mbajë të njëjtin post për dy mandate me radhë, duket se tani ai duhet të mendojë mirë se ku do ta hedhë këto zgjedhje kandidaturën: për dekan të Filologjikut, post të cilin e mban që në vitin 2008, apo për rektor të Universitetit të Tiranës, ku i duhet të përballet me rektorin aktual Dhori Kule, të cilit ai i la vendin. Sigurisht në këtë garë mund të marrin pjesë të gjithë profesorët që plotësojnë disa kushte minimale, por ne iu referuam këtyre dy figurave, pasi në kohën kur ata kanë ndërruar postet ka ndryshuar edhe ligji. Aktualisht të gjithë fakultetet kanë filluar të bëjnë gati kandidaturat për dekanë, emrat e të cilëve do të shpallen zyrtarisht në muajin dhjetor kur edhe do të çelet fushata për rektorë dhe dekanë. Për herë të parë në vitin 2008, edhe votës së studentëve iu dha një peshë e rëndësishme, në totalin e përgjithshëm të votave që e bëjnë një kandidaturë rektor ose dekan.

**? PYETJE PERGJIGJE**

**■ Kur mbahen zgjedhjet reja në universitete?**
Zgjedhjet e reja në universitete, do të mbahen në fillim të muajit janar dhe nga këto zgjedhje do të dalin dekanët, rektorët këshillat e fakulteteve dhe këshillat studentorë të rinj. Ata kanë një mandat katër vjeçar.

**■ Çfarë mendojnë profesorët?**
Një pjesë e madhe e profesorëve janë të pakënqaur, pasi ligji për mandatet e rektorëve dhe të dekanit, pritet të ndryshojë së shpejti.

**■ Çfarë parashikojnë këto ndryshime?**
Sipas këtij ndryshimi të ligjit, rektorët dhe dekanët aktualë mund të rikandidojnë sërish për të njëjtin post, ndërkohë që ligji që i solli ata në këtë pozicion, ndalonte që një dekan apo rektor të mbante të njëjtin post për dy mandate radhazi.

**■ A i ndalon ky ligj profesorët e tjerë të kandidojnë për këto poste?**
Jo ligji, nuk ndalon askënd që i ka përmbushur kriteret të kandidojë për këto poste.

**■ Po pse janë të pakënaqur profesorët?**
Një pjesë e profesorëve janë të pakënaqur, pasi ata tashmë mund ta kenë më të vështirë përballjen me të njëjtin person që mban prej katër vitesh të njëjtin post. Si dhe dekanët që duan të kandidojnë për rektor duhet të peshojnë mirë mundësitë dhe të zgjedhin nëse do e hedhin kandidaturën sërish për dekan apo kanë më shumë shpresa për vendin e rektorit.

### Kallëzim penal

# Shkolla "Wilson" pret pemët

TIRANE

Bashkia e Tiranës ka bërë një kallëzim penal për institucionin arsimor "Wilson". Kjo pasi, kjo shkollë, e cila ndodhet brenda parkut të Liqenit Artificial, ka prerë rreth 30 pemë. Në një dalje për mediat, nënkryetari i bashkisë, Edmond Panariti, ka shkuar në vendin e ngjarjes, ku ka treguar edhe dëmin që i ka shkaktuar ky institucion parkut të Liqenit. Ai ka deklaaruar se policia Bashkiake konstatoi pemët e prera dhe prova të tjera materiale në zonën ku është kryer dëmi ndaj pasurisë së qytetarëve të Tiranës. "Shpreh tronditjen e thellë për këtë masakër mjedisore, për këtë krim mjedisor. Bëhet akoma më dramatike dhe problematike kjo situatë, kur në qendër të ngjarjes ndodhet i përfshirë një institucion arsimor, i cili duhet të bëjë të kundërtën. Në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror, ne do të marrim të gjithë masat e tjera, deri në revokim të licencës për ushtrimin e aktivitetit", - ka deklaruar Panariti. Ai gjithashtu ka shpjegiuar se duke filluar që nga dita e sotme Bashkia e Tiranës do të bëjë një inventarizim të detajuar të çdo bime, të çdo peme, të çdo shkurre dekorative në Parkun e Liqenit Artificial dhe kjo pas dy tre ditësh do të shoqërohet edhe me kalimin e statusit të Parkut Natyror Rajonal për Liqenin që do të jetë garancia dhe mbrojtja ligjore që do i jepet këtij fondi të vyer të kryeqytetit.

**Lajmi**

**Bashkia e Tiranës ka depozituar një kallëzim penal për shkollën "Wilson' që ndodhet brenda parkut të liqenit të Tiranës, pasi ka prerë rreth 30 pemë. Nënkryetari i Bashkisë ka deklaruar se ata do të kërkojnë deri në revokim të licencës për këtë institucion**

## Përballja dhe akuzat

**PIKËNISJA** *Akademiku tha se politizimi i skajshëm i Akademisë është i papranueshëm dhe i dëmshëm për Kosovën. Madje, disa prej kolegëve të tij, Qosja i konsideroi si të paaftë për të qenë anëtarë të Akademisë dhe për të marrë rrogë, siç e quajti ai, kombëtare...*

# Rexhep Qosja mes një debati të ashpër në Kosovë

## Replikat nisën nga një intervistë e akademikut ku akuzonte Akademinë e Shkencave si shtëpi partiake e LDK-së

ADMIRINA PEÇI

Akademiku Rexhep Qosja është përfshirë mes një debati të ashpër këto ditë në Kosovë. Ai ka hedhur një varg akuzash ndaj kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, duke deklaruar se Akademia është shndërruar në një shtëpi partiake e LDK-së. Menjëherë pas kësaj Kryesia LDK-së ka reaguar ashpër ndaj këtyre akuzave, dhe kryesia e ASHAK-s doli shumë shpejt me një qëndrim zyrtar, i mbushur me përgënjeshtrime.

> Mehmet Kraja tha se “me ose pa ndihmën tonë, por me nxitje të shëmtuara politike, po krijohet një atmosferë antiintelektuale, më e keqja që kam parë ndonjëherë”



**Në foto:** Nga promovimi i veprës së plotë të Qoses, të mërkurën në Prishtinë

**Gjithçka ka nisur nga një intervistë e Qosjes dhënë 'Kosovapress', ku ai tha se politizimi i skajshëm i Akademisë është i papranueshëm dhe i dëmshëm për Kosovën.** Madje, disa prej kolegëve të tij, Qosja i konsideroi si të paaftë për të qenë anëtarë të Akademisë dhe për të marrë rrogë, siç e quajti ai, kombëtare.

**"Shkoni në Akademi e shikoni disa emra aty. Shkoni në seksionin e gjuhës dhe letërsisë. Janë aty disa njerëz, e meritojnë t'u japë Kosova rroga kombëtare?** Jo, kurrë. S'kanë bërë punë as shkencore, as artistike, as arsimore, as kulturore që të meritojnë të marrin rrogë kombëtare prej Kosovës. Jo", është shprehur ai, duke mos përmendur ndonjë emër të caktuar.

**Anëtarë të rregullt të seksionit të gjuhësisë dhe letërsisë janë: Idriz Ajeti, Ali Aliu, Besim Bokshi, Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Mehmet Kraja, Ali Podrimja dhe Rexhep Qosja.**

### REAGIMI I MEHMET KRAJËS

Mehmet Kraja, sekretar i këtij seksioni, e konsideron të panevojshëm, joproduktiv, madje të tepruar dhe pa shumë etikë debatin e këtillë rreth Akademisë. Këtë atmosferë të krijuar, ai e konsideron si antiintelektuale dhe të dëmshme.

**"Me ose pa ndihmën tonë, por me nxitje të shëmtuara politike, po krijohet një atmosferë antiintelektuale, më e keqja që kam parë ndonjëherë.** Unë nuk dua të jem pjesë e kësaj atmosfere, e këtij ambienti", tha për gazetën Express në Prishtinë Kraja, duke refuzuar të japë përgjigje të drejtpërdrejtë lidhur me akuzat e Qosjes.

**"Unë nuk dua të bëhem argat i askujt që ta fyej Rexhep Qosjen, sikundër që do të doja që as Qosja të mos bëhej argat i kujtdo qoftë dhe të fyejë kolegët e tij.** Atyre që fërkojnë duart për zënka të këtilla, kësaj radhe nuk do t'ua jap asnjë kënaqësi", tha Kraja.

**Lidhur me akuzat e Qosjes, sipas të cilit disa prej gjuhëtarëve e kanë bërë akademinë prapavijë të fushatës që po bëhet ndaj gjuhës standarde, Kraja theksoi se nga funksioni** ku është, ka bërë dhe vazhdon të bëjë përpjekje të vazhdueshme për funksionalizimin e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, i cili, sipas tij, duke mbledhur së bashku gjuhëtarët më të mirë të Shqipërisë dhe të Kosovës, do t'i jipte përgjigjet më kompetente për të gjitha çështjet e hapura rreth standardit, nëse ka të tilla.

**"Unë nuk besoj se dikush tjetër do të mund të bënte diçka më mirë se 15, 17, 19 ose 21 gjuhëtarët më të mirë shqiptarë, të mbledhur në një këshill, ku vendimet do të merreshin me konsensus, ose me dy të tretat e votave.** Për mendimin tim, nëse këtij Këshilli i krijojmë hapësirë për punë, pa asnjë ndërhyrje, besoj se do t'i bënim shërbimin më të mirë gjuhës sonë, të cilën gjithashtu po e lëndojmë me këto ndërhyrje të shëmtuara", tha Kraja.

### REAGIMI I NEXHAT DACIT

Akuzat e Qosjes, Nexhat Daci, akademik dhe kryetar i LDD-së, i quajti "gafë për një çmim shumë të lartë".

**Në një intervistë për Kosovapress, akademik Daci tha se ka respekt për krijimtarinë e akademik Rexhep Qosjes, por e konsideron si një prej individëve që merr beneficione nga Akademeia e shkencave dhe arteve të Kosovës pa participuar në jetën akademike.**

"Individët që nuk participojnë në jetën e Akademisë për më shumë se 15 vjet dhe që i marrin të gjitha beneficionet e akademisë nuk do t'i komentoja", është shprehur Daci.

### ASHPËRSIA E ZYRTARËVE TË LDK

Prej atyre që reaguan ndaj deklaratave të Qosjes, më të ashprit qenë zyrtarët e LDK-së. Vet kryetari i kësaj partie, Isa Mustafa, i cili është edhe anëtar i akademisë, është shprehur se "Qosjes iu ka vonuar mendimi sikurse revolucioni"..

**"Ai ka komplekse nga LDK-ja, një ditë do të çmendet, por nuk është përgjegjësi e jona", ka thënë Mustafa për Klan Kosova.** Ndërkaq, në një reagim të kryesisë së LDK-së thuhet se prapa Qosjes qëndron partia në pushtet, PDK.

"PDK-ja synon të shtetëzojë ASHAK-në, për të vënë kontroll politik e ideologjik mbi institucionin më të lartë të dijes, shkencës dhe të kulturës në Republikën e Kosovës", thuhet në reagimin e LDK-së.

**Sipas kryesisë së kësaj partie, Qosja ëndërron institucione të kontrolluara nga partia të cilës i shërben, institucione në të cilat njerëzit dërgohen siç është dërguar ai** në Akademinë e shkencave dhe arteve të Kosovës në kohën e tij.

### REAGON AKADEMIA

Të mërkurën Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, përmes një komunikate,

## Revista në Prishtinë

# 'Jeta e re', 500 faqe kushtuar Kadaresë

Numri i ri i revistës letrare "Jeta e Re", botim i Prishtinës, që këtë herë ka 500 faqe, i kushtohet shkrimtarit shqiptar me famë botërore, Ismail Kadare. Për lexuesit e kësaj reviste ai ka dhënë një intervistë interesante në të cilën flet për letërsinë, tiraninë, dashurinë dhe për shumëçka tjetër. Pos shkrimeve të Kadaresë në prozë, poezi e dramë, në këtë numër botohen edhe shkrime të rëndësishme të autorëve të huaj dhe të atyre shqiptarë. Nga autorët e huaj janë: shkrimtari i madh John Updike, kritiku i mirënjohur anglez John Carey, studiuesi dhe shkrimtari



francez Eric Faye, por edhe James Wood, Alain Bosquet, Robert Elsie e shumë të tjerë. Nga autorët shqiptarë është bërë një përzgjedhje paksa më heterogjene, me studiues, shkrimtarë, eseistë, profesorë, studentë etj., për ta parë veprën e Kadaresë nga perspektiva të ndryshme. Disa nga autorët shqiptarë prezentë në këtë numër janë Martin Camaj, Arshi Pipa, Rexhep Qosja, Ramiz Kelmendi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Shaban Sinani, Agron Tufa, Milazim Krasniqi, Basri Çapriqi, Enver Robelli, Gëzim Aliu, Viola Isufaj, Ag Apolloni, Donika Dabishevci, Ndue Ukaj, Beqë Cufaj, Sali Bashota, Bajram Krasniqi, etj. Përveç me shkrime të shumta, ku numër i "Jetës së Re" plotësohet edhe me fotografi, piktura dhe ilustrime. Duke marrë për moto thënien e kritikut Richard Eder, se "Bota e Ismail Kadaresë është një lloj anti-materie. Ajo mund ta shkatërrojë tonën. Vetëm se ndryshe nga ç'ndodh me grimcat elementare në fizikë, bota e tij plotëson tonën duke lënë gjurmë të jashtëzakonshme", redaksia e "Jetës së Re" ofron një dritare nga e cila mund të kundrohet ajo botë magjike.





## Nexhat Daci

“Individët që nuk participojnë në jetën e Akademisë për më shumë se 15 vjet dhe që i marrin të gjitha beneficionet e akademisë nuk do t’i komentoja”



## Mehmet Kraja

Unë nuk dua të bëhem argat i askujt që ta fyej Rexhep Qosjen, sikundër që do të doja që as Qosja të mos bëhej argat i kujtdo qoftë dhe të fyejë kolegët e tij

reagoi ashpër ndaj deklaratave të para pak ditëve të Rexhep Qosjes. E quajtën servil të vetëm të pushtetit. Madje nuk u kursye as veprimtaria, e as e kaluara e tij.

**Në reagimin e ASHAK-ut, të nënshkruar nga akademiku Besim Bokshi, mes tjerash thuhet se, akademiku Qosja nuk thotë të vërtetën kur pohon se "në Akademi bashkë me të janë vetëm edhe dy a tre akademikë që nuk janë anëtarë të LDK'së",** sepse "e vërteta është se në tërë Akademinë vetëm dy akademikë janë anëtarë të LDK'së", edhe pse ata në asnjë rast nuk ushtrojnë ndikim partiak.

**Kryesia e ASHAK reagon edhe ndaj pohimeve të Qosjes, se Isa Mustafa është zgjedhur anëtar i ASHAK'ut, megjithëse ky është veprim antiligjor.**

"E vërteta është se Ligji për Akademinë, që e ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës më 2004, me asnjë nen nuk e ndalon zgjedhjen e ndonjë funksionari anëtar të Akademisë, kështu që zgjedhja e tij nuk ishte në kundërshtim me ligjin. Z. Mustafa është zgjedhur anëtar korrespondent i Akademisë si shkencëtar dhe ekonomist, në bazë të propozimeve përkatëse, sipas ligjit. Akademia nuk ka pasur kurrfarë interesi që të zgjedhë kryetarin e Komunës', theksohet në reagim, derisa sqarohet se Akademia Mustafën e ka trajtuar sikurse të gjithë "anëtarët e tjerë korrespondentë dhe ai është sjellë vetëm si i tillë në kryerjen e punëve që ia ka caktuar Seksioni i Shkencave Shoqërore, pa as më të voglin gjest të sjelljes si autoritet politik".

**Kryesia e SHAK e quan të pavërtetë dhe tendencioz edhe vlerësimi e Qosjes, "se Akademia është politizuar skajshmërisht e se është bërë 'shtëpi partiake' e Lidhjes Demokratike të Kosovës".**

"E vërteta është se deri tash asnjë parti nuk ka shfaqur shenja për të dirigjuar punët e këtij institucioni të lartë të shkencës e të artit, asnjë synim për të cënuar pavarësinë dhe autonominë e tij. Me këtë shpifje, paturpësia e tij do që ta bëjë të nevojshëm ndëshkimin e dëshiruar prej tij dhe prej mbështetësve të tij ndaj Akademisë", theksohet në reagim,



Qosja: Shkoni në Akademi e shikoni disa emra aty. Shkoni në seksionin e gjuhës dhe letërsisë. Janë aty disa njerëz, e meritojnë t'u japë Kosova rroga kombëtare? Jo, kurrë

Ndërkohë kujtohet edhe fakti se, përkundër akuzave të tilla "Qosja çdo herë është në listën e kandidatëve për zgjedhje në të gjitha funksionet e Akademisë, por nuk ka marrë votë".

**Në reagimin e ashpër të Kryesisë së ASHAK, vihet theksi edhe në pohimin e Qosjes se disa akademikë "bëjnë luftë kundër gjuhës standarde".**

"Gjuhëtarët e Akademisë sonë janë anëtarë të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Standarde të iniciuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bazë të vendimit të Konferencës gjuhësore 'Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot', të mbajtur më 2002", thekson Kryesia në reagim, duke sqaruar se i njëjti Këshill "nuk është krijuar për të luftuar gjuhën standarde, por për ta begatuar aftësinë shprehëse të saj e të funksionalizimit shoqëror", thohet në këtë reagim zyrtar të Akademisë.

### QOSJA NUK I PËRFILL

Ndërsa debatet janë ashpërsuar e politizuar, akademiku Qosja nuk është prononcuar më tej mbi këtë çështje, duke i lënë mënjanë reagimet dhe duke I shpërfillur deklamiet esi të LDKosë ashtu edhe të Akademisë së shkencave. Ai u shfaq para mediave vetëm gjatë promovimit të kolanës të veprave të tij prej njëzet e nëntë vëllimesh, ditën e mërkurë. Në këtë promovim merrte pjesë edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja.

**Ministri Buja para të pranishmëve theksoi rëndësinë e kësaj ngjarje për letërsinë dhe kulturën shqiptare dhe tha se njëzet e nëntë vëllimet e Qosjes,** jo vetëm që e dokumentojnë veprimtarinë e një krijuesi, por edhe i japin ndjesi të mirë lexuesit dhe e bëjnë krenar institucionin që ka ndihmuar botimin e tyre.

# Pashk Përvathi sjell "Vjeshtë 2011"

I quajtur ndryshe si piktori i stinës së vjeshtës Pashk Përvathi, vjen për publikun e kryeqytetit me një tjetër ekspozitë personale. Në qëndër të"Vjeshtë 2011" janë 35 veprat , ku 33 janë peisazhe, që shpalosin vjeshtën me të gjithë hijeshinë e saj. E veçanta këtë herë është se në dallim me krijimtarinë e mëparshme veprat kanë më shumë ekspresivitet dhe larmia koloristike është e shumëllojshme. Në këtë ekspozitë zënë një vend të veçantë peisazhet nga Polena dhe Vidhkuqi i Korçës, por nuk mungojnë edhe tablotë ku piktori është frymëzuar nga malet mahnitëse të luginës së Valbonës. Të gjitha pikturat Pashk Përvathi i ka realizuar përgjatë vitit 2011-të.

# "Nëntori" vjen me 50 punime në pikturë

Në Galerinë Kombëtare të Arteve më datë 26 Nëntor, ora 18.00, do të hapet ekspozita e grupimit të piktorëve 'Nëntori'. Ky grupim i formuar pas viteve 1990 përbëhet nga piktorë të brezave të ndryshëm që i bashkon zhanri dhe vazhdimësia e traditës së pikturës në Shqipëri. Një pjesë e tyre janë të përfaqësuar me vepra edhe në linjën muzeale të Galerisë Kombëtare në sallat: 'Realizmi Socialist: 1960-1986' dhe 'Piktura dhe Skulptura Moderniste: 1989-2001'. Kjo ekspozitë është e organizuar nga vetë grupimi. Në të marrin pjesë 29 artistë dhe do të ekspozohen rreth 50 punime në pikturë. Artistët pjesëmarrës janë: Agim Zajmi, Agron Mesi, Aleksandër Filipi, Adrian Devolli, Andi Hila, Bashkim Dervishi, Besim Tula, Brikena Berdo, Buron Kaceli, Eniela Vevecka, Gazmend Leka, Gjergji Marko, Hasan Çapari, Hasan Nallbani, Ksenofon Dilo, Kujtim Buza, Llazar Myzeqari, Llazar Taci, Ledia Kostandini, Merita Selimi, Nikolin Ivanaj, Pashk Përvathi, Petro Kokushta, Qirjako Meniko, Robert Guci, Sali Shijaku, Stefan Taci, Zef Shoshi dhe Vilson Kilica. Kuratorë të ekspozitës janë Aleksander Filipi dhe Adrian Devolli. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më datë 16 Dhjetor 2011.

# Kurbani i Edi Ramës edhe në Kosovë

Libri I Edi ramës"Kurbani" do të njohë edhe nëj promovim në kosovë. Lajmin e bëri të ditur shtëpia botuese 'Dudaj', sipas të cilës se të shtunën, më 26 nëntor, në ora 18:00, në Muzun Kombëtar të Kosovës, në Prishtinë, do të bëjë promovimin e librit të ri të kryetarit të PS'së, Edi Rama. Libri "Kurban", gjatë Panairit të Librit në Tiranë ishte ndër librat më të shitur. Libri paraqet një vështrim ndryshe të ngjarjeve dhe protagonistëve kryesorë politikë në Tiranë, të parë nga këndvështrimi i kryetarit të opozitës shqiptare, Edi Rama. Ndryshe, vepra a Ramës është lavdëruar shumë nga kritika në Tiranë, para së gjithash për nga mënyra e shkrimit dhe e trajtimit të ngjarjeve protagonist i të cilave ka qenë edhe vetë ai.

## LAJMET NE 5 RRESHTA

**• Itali, pranga 3 shqiptarëve vodhën 150 mijë euro**
Tre emigrantë të rregullt dhe me dokumente janë vënë në prangat e policisë italiane se pavarësisht rregullshmërisë së tyre ligjore fshihnin një veprimtari të dytë. Tre të rinjtë të identifikuar si Marsel Hoxha 24 vjeç, Frederik Gjonaj 22 vjeç dhe Ardian Lleshi 33 vjeç ishin të dyshuar se kishin kryer një sërë vjedhjesh në tre banesa të ndryshme në zonën e Venecias dhe Venetos. Në banesën e tyre në një fermë u gjetën nga policia mjete të vjedhura që kapnin vlerën e 150 mijë eurove përveç parave të thata, florinjve dhe materialeve të shumta kompjuterike. Mësohet se hetimi kishte nisur në fund të tetorit, kur në një zonë tjetër ishte vjedhur një makinë.

**• TI: Partitë të tregojnë financat**
Transparency International i bën thirrje Shqipërisë, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë e Serbisë të garantojnë raportime të sakta e të plota mbi të ardhurat dhe shpenzimet e partive politike. Sipas raportit të publikuar dje financimimit të partive politike në pesë vendet e evropës juglindore, i mungojnë masa të forta transparence dhe sanksionet e duhura. Transparency International bën thirrje që financat e partive politike të verifikohen përmes një sistem të besueshëm. Raporti u bën thirrje agjencive kontrolluese të rrisin përpjekjet për miratimin e ligjeve të reja mbi financimin e partive politike.

**• Jahjaga e Thaçi: Jo barrikada në Mitrovicë**
Presidentja e Kosovës, Ahtifete Jahjaga dhe kryeministri Hashim Thaçi dënuan dhunën në Mitrovicë ku u plagosën 21 ushtarë të NATO-s në tentativë për të hequr barrikadat me gurë që kanë ngritur banorët serbë të zonës. Që prej korrikut serbët kanë ngritur 20 barrikada duke penguar lëvizjen e lirë në shenjë kundërshtimi për shtrirjen e autoritetit shtetëror të Prishtinës zyrtare dhe në këtë pjesë të Kosovës. Gjatë muajit shtator KFOR hoqi disa barrikada por serbët i rindërtuan ato.

**• Zjarr në trenin Tiranë Durrës**
Një zjarr i befasishëm frikësoi pasagjerët e trenit të linjës Tiranë Durrës. Lokomotiva e këtij treni që po udhëtonte në zonën e Sukthit u përfshi nga flakët. Mashinistët në shpejtësi bënë shkëputjen e vagonit si dhe larguan të gjithë pasagjerët e trenit duke mos paraqitur asnjë rrezik për ta. Treni kishte dy vagona me rreth 50 pasagjerë por nuk pati të lënduar. Më pas zjarrfikësit shuan zjarrin ndërkohë që shkaqet mbeten ende të panjohura.

**• Miku më i mirë i Izraelit? Shqipëria**
Mediat në Izrael i kanë bërë jehonë vizitës së kryeministrit Sali Berisha atje tre ditë më parë. Jessica Elgot shkruan se "Shqipëria dhe Izraeli mund të duken se nuk kanë lidhje shpirtërore, por kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha është shprehur se dy vendet janë model për bashkëjetesën dhe respektin reciprok. Berisha listoi një listë të përbashkët: të dy vendet i tremben rritjes së radikalizmit islam, kundërshtojnë njohjen e shtetit të Palestinës nga OKB, e shohin Iranin dhe presidentin Ahmedinexhad si një kërcënim të madh për paqen..." shkruan autorja.

Qendra tregtare më e madhe në Shqipëri
Hapet më 26 Nëntor 2011, Tiranë



Lindja e një destinacioni të ri.
Për herë të parë Hipermarketi më i madh Carrefour
TEG, Autostrada Tiranë - Elbasan, Km 0 / www.teg.al
TEG
tirana east gate

**Alba Malltezi**
Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group

**Anila Basha**
Drejtore e Shqiptarja.com

**Julia Dhame:**
Drejtore Marketingu
julia.dhame@shqiptarja.com

Politika: **Arben Rrozhani,**
Ekonomia: **Genc Kondi**

Investigimi: **Poli Hoxha**
Sociale: **Esmeralda Keta**
Kulturë: **Admirina Peçi**

*Design:* **Altin Aliaj, Tomka Nasi**
*Website:* **Suela Gera, Antuen Hoxha**

Shpërndarja: **Saimir Zenelaj**
Celular: **+355696060418**

**Redaksia:** Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë - Tiranë **E-mail:** redaksia@shqiptarja.com

**Shtypur në shtypshkronjën:**
A.K shpk, rruga 5 maji, Tiranë